



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave
në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i
Shqipërisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. PhD Klodiana Beshku
2. Prof. Asoc. Eda Gemi

Nëntor 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Marrëdhënie
Ndërkombëtare”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh 482, datë 03.10.2011.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 371 datë 23.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMASh Nr. 291, datë 11.07.2012 VBA Nr 66, datë 28.09.2018 VBA Nr. 66/1, datë 01.02.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite/ 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Nivel 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a (2020-2021): 10 PAE/ 2 PAK v.a (2019-2020): 9 PAE/ 2 PAK v.a (2018-2019): 7 PAE/ 4 PAK
18	Numri i studentëve (3 vitet e fundit):	v.a (2018- 2019): 35 studentë v.a (2019- 2020): 25 studentë v.a (2020- 2021): 42 studentë
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky është një raport i vlerësimit të jashtëm për Masterin e Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” përbëhet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, të cilat organizojnë: Studime të Ciklit të Parë "Bachelor", Program me karakter profesional dhe të Ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”.

Masteri i shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare është një program studimi i orfruar që prej vitit 2011. Programi Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare është hartuar duke mbajtur në vëmendje nevojën që vendi ka për një brezë të diplomuarish të cilët do të angazhohen në proceset shumë të rëndësishme në të cilat është përfshirë Shqipëria. Këtu kemi parasysh procesin e integritimit evropian, forcimin e pozitive të vendit brenda NATO-s, intensifikimin e marrëdhënieve bilaterale të Shqipërisë në një sistem ndërkombëtar që gjithmonë e më shumë karakterizohet nga globalizimi dhe ndërvarësia, forcimin e pozitive të vendit në organizatat ndërkombëtare dhe intensifikimin e diplomacisë së vendit duke mbajtur parasysh rëndësinë gjithmonë e më të madhe që aspekti ekonomik dhe kulturor i diplomacisë ka në epokën e sotme.

Për t’ju përgjigjur këtyre nevojave, në vitin 2011, UMSH aplikon për hapjen e këtij programi, në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, e cila në bazë të Urdhërit 482 datë 03.10.2011, mundëson çeljen e tij dhe në vitin 2012, bazuar në Urdhërin 291 datë 11.07.2012 si dhe VKA 334, dt. 08.06.2012, programi akreditohet për herë të parë. Më pas programi është riakredituar në vitin 2018 me VBA NR.66 datë 28.09.2018 dhe VBA Nr. 61/1, datë 01.02.2019. Programi është pjesë përbërëse e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë në strukturën akademike të FSHJMN në UMSH, dhe kohëzgjatja e tij është dy vite akademike. Programi i studimit Master i shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare, është në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe i përket nivelit 7 (shtatë) sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Programi ofrohet në gjuhën shqipe dhe është i organizuar në module, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit, gjithsej 120 ECTS i ndarë në dy vite dhe katër semestra.

Në vitin 2018, UMSH-ja aplikon për riakreditimin e këtij programi. Bordi i Akreditimit, me VBA NR. 66, datë 28.09.2018 dhe VBA Nr. 61/1, datë 01.02.2019 ka miratuar akreditimin periodik me afat 3 vjeçar. Bordi i akreditimi përveç vlerësimit pozitiv i ka rekomanduar disa rekomandime të cilat synojnë përsosjen dhe qëndrueshmërinë e këtij programi i cili realisht ka qënë mjaft i suksesshëm.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË


Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 66, datë 28.09.2018, "Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Master i Shkencave në **Marrëdhënie Ndërkombëtare**, të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë", janë si vijon:

1. Institucioni, të realizojë një studim tregu më të detajuar dhe që ti referohet të dhënave konkrete të punësimit të studentëve të diplomuar si dhe nevojave konkrete të tregut për studentët e këtij profili në përgjithësi.
2. Institucioni, të sigurojë një shpërndarje më harmonike të lëndëve ndërmjet dy viteve të programit, duke transferuar disa module nga viti i parë në të dytë dhe anasjelltas, kalimin e një pjese të modulit në nivelin Bachelor apo edhe integrimin e disa komponentëve të rinj, veçanërisht duke mbajtur parasysh procesin e integritit evropian.
3. Institucioni, nevojitet të ketë një strategji të qartë lidhur me hapat e zhvillimit të partneritetit me institucione të huaja akademike, për të arritur në ndërtimin e programeve që mund të rezultojnë në një diplomë të përbashkët apo të dyfishtë, si psh. Erasmus +, me qëllim ndërkombëtarizimin e programit të studimit.
4. Institucioni, të institucionalizojë modele bashkëpunimi me institucione publike dhe private lidhur me kriteret e praktikave mësimore, si edhe një specifikim konkret të kushteve që duhet të plotësojnë si studentët ashtu edhe institucionet gjatë kësaj periudhe.
5. Institucioni, të rishikojë përputhshmërinë midis profilit akademik të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe lëndëve që ata mbulojnë.
6. Institucioni, të stimulojë publikimet e pedagogëve me kohë të plotë, si duke i vendosur ato në kriteret e vlerësimit ashtu edhe duke ndihmuar me lehtësimin e ngarkesës mësimore për ti dedikuar më shumë kohë publikimeve, ndonëse ngarkesa mësimore është në nivele mjaft të pranueshme në krahasim me ngarkesën e ofruar nga dispozitat ligjore.
7. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik me kohë të plotë, me tituj akademikë, për të krijuar një brez të ndërmjetëm akademik ndërmjet Profesorëve dhe Dr/PhD, veçanërisht për stafin akademik me kohë të plotë, megjithëse është në përmbushje të detyrimeve minimale ligjore.
8. Institucioni, të nxisë mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve, duke marrë pjesë në programe të dedikuara për këtë qëllim, si Erasmus+, ku mirëpritet angazhimi i universiteteve nga Ballkani perëndimor në veçanti.
9. Institucioni, të përditësojë dhe standardizojë syllabuset, duke nxjerrë në pah dijet e synuara dhe/ose të përfuara nga studentët në përfundim të çdo lënde dhe duke përfshirë literaturë bazë dhe ndihmëse sa më cilësore dhe bashkëkohore.

Plotësimi i tyre nga Institucioni:

1. Institucioni ka kryer studim tregu i cili në aspektin metodik përfshin analizën e kërkesës dhe ofertës sipas metodologjisë europiane të studimit të tregut të punës, ku përfshihen tregues kombëtarë por dhe tregues të rajonit ballkanik. Në projektimin dhe realizimin e tij janë mbajtur parasysh: të dhënat e INSTAT mbi kërkesat e tregut për punësim, sipas profilit që ofrohet; kërkesat

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë E-mail: info@ascal.al



e punëdhënësve; të dhënat e MASR për fluksin e maturanëve drejt IAL publike dhe jo publike, programet e ofruara. Studimi ka analizuar kërkesën duke marrë në konsideratë portalet e zyrave të punës, ndryshimet e tregut të punës, numrin e të regjistruarave në IAL në këtë profil dhe shumë elementë të tjerë për të përllogaritur në mënyrë të përafërt numrin e studentëve që do kenë mundësinë e punësimit pas mbarimit të programit në këtë profesion.

Evidenca 16. Analiza e tregut të punës

2. Institucioni ka kryer disa kalime lëndësh e modulesh si edhe ka kryer integrimin e disa komponentëve të rinj, por nuk e ka bërë këtë duke “mbajtur parasysh procesin e integritit evropian” sipas rekomandimeve.

Pas rekomandimit të dytë, në programin e studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare janë bërë ndryshime në disa lëndë si vijon (**Evidenca 23: RVB**)

- Lënda Doktrinat themelore të rendit botëror është bërë një nga modulet e lëndës Teoritë e integritit rajonal dhe global dhe moduli tjetër është Teoritë e Integritit Evropian;
- Lënda International Relations in English zëvendësohet me lëndën Teori Politike E Shtetit
- Lënda Insitucione Dhe Administrate E BE-së ka është zëvendësuar me lëndën Politika Ekonomike Të Krahasuara.
- Module të lëndës Insitucione Dhe Administrate e BE-së kanë kaluar në programin e studimit të ciklit të parë.

Siç shihet nga këtu, lëndë të integritit evropian janë tjetërsuar ose përjashtuar, në kundërshti me këtë rekomandim (Evidenca 23. RVB; Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN Tabela 11 Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licencuara)

3. Institucioni ka një strategji të qartë në lidhje me zhvillimin e partneritetit me institucione të huaja akademike me qëllim ndërkombëtarizimin e programit të studimit. Në këtë frymë, UMSH ka ndërmarrë hapa konkretë dhe ka filluar punën për krijimin e programeve të reja si bashkëpunim ndërmjet fakulteteve analoge duke ofruar diploma të dyfishta.

Evidenca 8. Strategjia e Nderkombëtarizimit të UMSH

Aneks 1. Urdhër i brendshëm i Rektorit të UMSH

Aneks 2. Kopje e marrëveshjes bilaterale midis UMSH dhe Universiteti i Tuscia

4. UMSH ka institucionalizuar modelin e bashkëpunimi me institucione publike dhe private duke specifikuar kriteret e praktikave mësimore, si edhe kushtet që duhet të plotësojnë si studentët ashtu edhe institucionet gjatë kësaj periudhe. Në këtë kuadër, është ndërtuar edhe një praktikë e cila është rregulluar me aktet përkatëse të institucionit.

Evidenca 39. Udhëzim për Praktikën

5. Stafit akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare, përbëhet nga personel akademik me kohë të pjesshme dhe të plotë të cilët zotërojnë kualifikimin e duhur shkencor, kryesisht me tituj e grada shkencore dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe me procedurat përkatëse të Zyrës së Burimeve Njërëzore. Përvoja e gjatë e stafit akademik në mësimdhënie dhe në fushat e ekspertizës garanton plotësimin e kërkesave ligjore dhe siguron profesionalizëm në organizimin e programit të studimit. Në këtë program janë angazhuar përgjatë viteve pedagogë të kategorisë profesor dhe lektorë të doktoruar në universitete brenda dhe jashtë vendit dhe profili dhe ekspertiza e tyre kërkimore janë në përputhje me lëndët që ata zhvillojnë.

Evidenca. 13. CV e stafit akademik të programit të studimit MSCMN

Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN Tabela 6 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit

6. Në UMSH kërkimi shkencor është i lidhur ngushtë me punën për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, me rritjen e nivelit të pedagogëve dhe me procesin e ndërkombëtarizimit të programeve të institucionit. Niveli i kërkimit shkencor vlerësohet periodikisht si në aspektin sasior ashtu dhe në atë cilësor. UMSH ndjek një politikë mbështetëse ndaj publikimeve shkencore dhe rritja e numrave të botimit të revistës brenda një viti, botimet e tjera shkencore si tekste, monografi, materiale ndihmëse për studentët, etj, kanë sjellë një rritje të mundësisë së studentëve për tu informuar me të rehat më të fundit në të gjitha fushat. Institucioni harton strategjinë afatgjatë të kërkimit shkencor dhe ndjek hap pas hapi realizimin e objektivave. Cdo pedagog dorëzon një raport të hollësishëm të punës shkencore të realizuar gjatë vitit akademik dhe një planifikim për vitin pasardhës, si pjesë e kontratës së punës të lidhur me institucionin.

Evidenca 23. Raport i Vetëvlerësimit.

<https://www.umsh.edu.al/c/69/revista-euro-mediterranean>

<https://www.umsh.edu.al/c/115/arkiva-konferenca>

7. Organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare përmbush të gjithë kriteret ligjore dhe ato të cilësisë. Stafit i angazhuar në këtë program studimi, përbëhet nga pedagogë të moshave të ndryshme dhe eksperiencave akademike të larmishme i cili, për sa i përket përkushtimit mësimdhënës e shkencor, vepron si njësi e pandashme dhe ka në përbërjen e vet pedagogë të moshave 35-40 vjeç, të cilët pas përfitimit të gradës shkencore Phd janë duke pasuruar përvojat e tyre profesionale, akademike e shkencore.

Evidenca. 13. CV e stafit akademik të programit të studimit MSCMN

8. Edhe pse situata e pandemisë në të gjithë botën ka ndaluar udhëtimet dhe shkëmbimet midis studentëve dhe pedagogëve, si dhe ka cuar në frenim të aktiviteteve ndërkombëtare dhe me një ngrirje të shkëmbimeve Erasmus + UMSH nuk e ka ndaluar punën dhe aktualisht ka firmosur marrëveshje bilaterale të reja me:

- Universitetin e Bialystok, Poloni

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 6

- Universitetin e Tuscia, Itali
- Universitetin e Cukurova, Turqi

Në anën tjetër UMSH, ka firmosur marrëveshje Erasmus + KA107 për shkëmbimet e studentëve dhe pedagogëve me:

- Universitetin e Jagellonia, Poloni
- Universitetin e Shkencave Politike dhe Administratës Publike, Rumani
- Universitetin Jugperëndimor të Rilskit, Bullgari
- Universiteti i Biznesit dhe Shkencave të Aplikuara, Lituani

Ndërkohë, UMSH është në kontakt të vazhdueshëm dhe ka marrë përgjigje pozitive nga disa universitete të tjera në komunikimin zyrtar me zyrat e marrëdhënieve me jashtë dhe Erasmus +. Këto Universitete do të firmosin marrëveshjet me UMSH menjëherë pas përmirësimit të pandemisë dhe njoftimit të Komisionit Europian dhe EACEA për rifillimin e aktiviteteve Erasmus + KA1 për mobilitetin.

- La Sapienza, Itali,
- Universiteti Granadës, Spanjë,
- Universiteti Panteion i Athinës, Greqi
- Universiteti i Tuscia, Itali
- Universiteti i WSPA Lublin, Poloni
- Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Nysës, Poloni
- Universiteti Ca Foscari i Venecias, Itali,
- Universiteti i West Attica i Athinës, Greqi

Evidenca 19. Marrëveshjet e bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera.

9. Në nisje të çdo viti akademik, pedagogët, me kohë të plotë dhe/apo të pjesshme, dorëzojnë dhe miratojnë pranë Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare syllabus-et e përditësuara të lëndëve përkatëse. Ato ndërtohen në bazë të akteve nënligjore dhe akteve rregullatore të UMSH. Përditësimi i tyre, rregullohet dhe monitorohet nëpërmjet bashkëpunimit të Departamentit me NJSBCZHK, sipas një plani të detajuar në fillim të çdo semestri.

Një pjesë e mirë e syllabus-eve rezultojnë të papërditësuar me botime apo materiale të viteve të fundit në fushën apo disiplinën që ato mbulojnë. Literatura e detyrueshme mbërrin deri në vitin 2011, 2013 e ndërkaq nuk parashikohet literaturë e viteve të fundit as tek literaturë e sugjeruar (Evidenca 13. Programi Master - Syllabusët e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021).

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Grupi për vlerësimin e jashtëm i përbërë nga:

1. Prof. Asoc. Eda Gemi
2. PhD. Klodiana Beshku

Koordinatorë teknike për këtë proces është Msc. Aviola Bardhi

GVJ kreu në IAL vizitën e parashikuar në datat 8-9 Korrik 2021. Vizita shkoi sipas agjendës dhe u realizua në një klimë shumë pozitive dhe konstruktive.


Theksohet se GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar paraprakisht tërësinë e dokumentave dhe Raportin e Vetë-vlerësimit (RVB) të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të UMSH. Është pikërisht kombinimi i dokumentacionit institucional, të vënë në dispozicion, me RVB, të cilat kanë orientuar GVJ për formulimin e pyetjeve dhe komenteve të adresuara përgjatë vizitës dyditore në IAL si dhe seancave intervistuese me personelin akademik dhe administrativ të UMSH.

Raporti pasues pasqyron në mënyrë të objektive, profesionale dhe të paanshme cilësinë e Programit të Studimit “Master Shkencor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare” të ofruar nga UMSH.

Përveç vlerësimeve pozitive që GVJ vë në pah për mënyrën e organizimit të programit të studimit dhe cilësinë e mësimdhënies, ai gjithashtu jep disa sugjerime dhe/ose rekomandime, të cilat mund të kontribuojnë në rritjen e mëtejshme të niveleve akademike, kerkimore dhe administrative jo vetëm të programit të studimit në fjalë por edhe të UMSH, të krahasueshme gjithmonë me standartet ndërkombëtare.

Më datë 20.10.2021, përmes sistemit AMS, Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi dhe me shkresë zyrtare Nr. Prot, 85/34, datë 20.10.2021. Më datë 28.10.2021 UMSH përcjell në sistemin AMS shkresën me Nr. Prot, 1296 datë 28.10.2021 me të cilën shpreh dakordësin me përmbajtjen e draftit.

Sa më sipër, Draft- Raporti kthehet në Raport përfundimtar.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË “MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE”

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), ofron program studimi Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, i cili nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programi i studimit implementohet konform Ligjit 80/2015, ¹ Statutit të UMSH (2018) (Evidenca 1), ² dhe Planit Strategjik 2018-2023 të UMSH (Evidenca 6). Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është riakredituar nga ASCAL ³ me VBA NR. 66, datë 28.09.2018 dhe VBA Nr. 61/1, datë 01.02.2019 i vlefshëm deri në 30/09/2021. ⁴
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në Planin Strategjik të Zhvillimit të UMSH (Evidenca 6) si dhe Strategjinë e zhvillimit të programit (Evidenca 7), Programi i Studimit të Ciklit të dytë Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” sanksionon parimin e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e kulturore kombëtare.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit të Ciklit të dytë Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është në përputhje me qëllimet dhe misionin e UMSH si dhe fushën e veprimtarisë së Institucionit, të reflektuar në Planin strategjik të zhvillimit (Evidenca 6) si dhe Strategjinë e zhvillimit të programit (Evidenca 7). Programi është në përputhje me kërkesat e nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, ⁵ për njohuri dhe aftësi teorike dhe praktike të avancuara në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë.
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për	Sipas evidencave në dispozicion ⁶ dhe intervistave me stafin akademik të departamentit në UMSH, u konstatua se Programi synon përgatitjen e specialistëve në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci publike, të cilët mund të ofrojnë shërbime pranë Ministrisë së Jashtme të

¹Ligj Nr 80/2015 Neni 1, pika d.

² Kreu I, Neni 4, pika 2 (e); <https://www.umsh.edu.al/c/14/misioni-dhe-filozofia>

³ https://www.ascal.al/media/documents/rvj/PS_1099_653.pdf

⁴ QSHA, Urdhër 371, datë 23/10/2020.

⁵ <http://www.akafp.gov.al/kualifikimet-profesionale/korniza-shqiptare-e-kualifikimeve/>

⁶ Evidenca 1: Statuti i UMSH, Kreu I, Neni 4, pika 2 (e) & Evidenca 7: Strategjia e zhvillimit të programit MSC MN.

të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	RSH dhe administratës publike, organizatave ndërkombëtare si dhe në sektorin jo publik në nivel kombëtar. Në dokumentin e Analizës së Tregut të Punës për Programet e Studimit në Marrëdhëniet Ndërkombëtare (Evidenca 16, f.24-29) theksohet se këto studime duhet të jenë më interdisiplinare, gjë që reflektohet edhe në përmbajtjen dhe formën e programit të studimit. <i>Vihet re, gjithsesi, se Analiza e Tregut të Punës nuk thellohet në analizën e kornizës kërkesë-ofertë të tregut të punës në Shqipëri në lidhje me specializimin në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.</i>			
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, i ofror studentëve njohuri teorike dhe praktike interdisiplinore të cilat kombinojnë dijet juridike në marrëdhëniet ndërkombëtare me ato ekonomike dhe historiko-politike. Një qasje e tillë, e pasuruar paralelisht me lëndë të tilla si metodat e avancuara të kërkimit shkencor, krijojnë bazat e nevojshme metodologjike për studentëve që synojnë të thellojnë aftësimin e tyre në ciklin e tretë të studimeve. <i>Nga shqyrtimi i detajuar i evidencave përkatëse në nivel programi (Evidenca 13) dhe intervistave me personelin akademik u vu re se disa lëndë (si p.sh Metodot e avancuar të kërkimit shkencor) ofron dije teorike dhe praktike të përgjithshme, jo të specializuara në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Theksohet, gjithashtu, se dijet themelore teorike mbi marrëdhëniet ndërkombëtare (Teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare) nuk janë të përfshira në kurrikulën e programit. Mungesa në fjalë mund të krijojë boshllëk formimi për ato studentë që vijnë nga fusha të tjera studimi të ciklit bachelor përtej shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Standardi I.2	
Programi i studimit MSH është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në nivel institucional (Evidenca 6) dhe departamental (Evidenca 7) konstatohet se Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është hartuar në harmoni Planin Strategjik të Zhvillimit të UMSH (Evidenca 6), si dhe me objektivat strategjike afatmesme dhe afatgjata të artikuluar në Strategjinë e Zhvillimit të Programit MSCMN (Evidenca 7) në fushën e mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtëmet prioritare akademike të	Programi është në përputhje me Statutin e UMSH (Evidenca 1, Kreu VIII, Neni 62 & 63), Rregulloren e Organizimit të UMSH (Evidenca 2,

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 10


tij dhe demonstronjë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Kreu VI dhe Planin Strategjik të UMSH (2018-2023, f. 4), të zbrërthyer dhe të reflektuara këto në Strategjinë e Zhvillimit të Programit MSCMN (Evidenca 7) dhe në Analizën Vjetore të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (Evidenca 22).			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e Programit të studimit (Evidenca 13) ofrohet në përputhje të plotë me fushat dhe drejtimet akademike të UMSH, të artikuluar këto në nivel institucional dhe më konkretisht në Statutin (Evidenca 1), Rregulloren e Organizimit (Evidenca 2) dhe Planin Strategjik 2018-2023 (Evidenca 6). Në nivel fakulteti, departamenti dhe programi, si më sipër gjenden të përfshira në Rregulloret përkatëse (Evidencat 3, 4 & 5), si dhe në Strategjinë e Zhvillimit të Programit në shqyrtim (Evidenca 7).			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit të RSH duke reflektuar kështu interesin kombëtar (Evidenca 1 & 6). Qasja dhe artikulli i kurikulës i jep rëndësi të veçantë dimensionit juridik të marrëdhënieve ndërkombëtare duke i mëshuar në veçanti temave të Integritimit Europian (Evidencat 7 & 13). Reflektimi i trendeve globale të zhvillimit del në pah jo vetëm nga struktura e kurikulës së programit në fjalë, por edhe nga tendenca e mireorganizuar e ndërkombëtarizimit të tij nëpërmjet hartimit të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të UMSH (Evidenca 8), si dhe të Marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të institucione të huaja (Evidenca 19).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3 Programi i studimit “Master i shkencave” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Objektivat për formimin e studentëve në Programin e Studimit Master i shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” janë evidentuar qartë në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve. Më konkretisht, detajet dhe analiza e tërësisë së njohurive shkencore, si dhe aftësive dhe kompetencave profesionale janë të përcaktuara qartë në Strategjinë e zhvillimit të programit (Evidenca 7); Rregulloren e programit të studimit (Evidenca 5), dhe në Analizën e tregut të punës (Evidenca 16). <i>Ndërsa në faqen elektronike të UMSH gjendet i publikuar vetëm Plani Mësimor i MSMN⁷</i>

⁷ <https://www.umsh.edu.al/media/5f0f6cbb9e784.pdf>

	<p><i>pa informacion shtesë rreth profilit specifik të programit dhe korrelacionit të tij me tregun e punës. Në Analizën e Tregut të Punës mungon, gjithashtu, konkretizimi i diptikut kërkesë-ofertë i projektuar në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>UMSH ka kryer studime të tregut të punës në nivel kombëtar dhe të rajonit të Ballkanit. Më konkretisht, UMSH ka aplikuar metodologjinë e kërkimit të tregut bazuar në të dhënat e ofruara nga institucionet publike dhe jo publike si dhe ato të gjeneruara nga vetë institucioni. Rezultatet gjenden të përmbledhura në Raportin e Analizës së Tregut të Punës (Evidenca 16) për vitet akademike: 2018-2019 dhe 2019-2020.</p> <p>Për Programin e Studimit në Marrëdhënie Ndërkombëtare, Raporti i Analizës së Tregut të Punës (Evidenca 16, ff. 24-29) është bazuar tek të dhënat e gjeneruara nga studime ndërkombëtare me fokus rajonal; nga INSTAT (arsimi publik në nivel bachelor dhe master) në nivel kombëtar dhe lokal, dhe së fundi nga shifrat e nivelit të punësimit të të diplomuarve të MSCMN për periudhën 2017-2020 (Evidenca 18, Tabela 23).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” ka si objektivi parësor pajisjen e studentëve me njohuritë themelore për formimin e tyre si specialistë të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të diplomacisë. Për realizimin e këtij objektivi, Programi MSCMN i ka dhënë prioritet edukimit cilësor, kërkimit shkencor dhe partneriteteve me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare (Evidenca 7).</p> <p>Struktura, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve janë në funksion dhe në përputhje me objektivat formuese dhe zhvillimore të Programit (Evidenca 7), Planin mësimor (Evidenca 18) dhe Syllabuset (Evidenca 13). Ato sigurojnë formimin teorik dhe praktik të specialistëve në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomaci.</p> <p>Komenti i GJV i referuar në Kriterin 5, Standardi I.1 vlen dhe për kriterin në fjalë.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo</p>	<p>Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të tillë që studentet pas përfundimit të studimeve të kenë mundësi të pershtaten dhe të integrohen në tregun ndërkombëtar të punës. Elementët interdisiplinorë të cilat përafrojnë dijet juridike në</p>

<p>punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>marredhëniet nderkombëtare me ato ekonomike dhe historiko-politike, krijojnë hapësira lehtësuese në transferimin e studimeve ne institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë. Përpos kësaj, programi është hartuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ligji për Arsimin e Lartë të RSH (80/2015), Karta e Bolonjës, Zona Europiane e Arsimit të Lartë (ZEAL), si dhe sistemi evropian i krediteve (ECTS) që mundëson transferimin e studimeve (Evidenca 1, Neni 76). Në Statutin e UMSH përcaktohet gjithashtu mundësia e ofrimit të programeve të studimit në bashkëpunim me IAL jashtë vendit dhe lëshimi i diplomave të përbashkëta (Evidenca 1, Neni 71).</p> <p>Strategjia e Ndërkombëtarizimit e UMSH (Evidenca 8) përcakton në mënyre eksplicite prioritetet shkencore, operationale dhe gjeografike qe do të kontribuojnë në krijimin e urave lidhëse midis UMSH dhe institucioneve homologe në nivel rajonal, EU dhe më gjerë. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UMSH me një numër të konsiderueshëm universitetesh brenda dhe jashtë vendit, institute studimi, OJF, institucione shtetërore, dhe organizata informuese, konkretizon më tej këtë tendencë duke e bërë më evidente përafrimin e MSCMN me tregun ndërkombëtar (Evidenca 19).</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit është përceptuar, hartuar dhe implementuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin e RSH (L.80/2015; niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve), dhe direktivave të BE-se për arsimin e lartë dhe profesionet të rregulluara.</p> <p>Mbështetur në përvojën 14-vjeçare të UMSH, Programi Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” implementohet konform akteve të brëndshme të UMSH në nivel institucional: Statuti (Evidenca 1, Neni 67) dhe Rregullore e Organizimit (Evidenca 2); në nivel fakulteti dhe departamenti (Evidencat 3 & 4), si dhe në nivel programi studimi (Evidencat 5 & 7).</p> <p>Programi i ofruar nga UMSH është i organizuar në module dhe të vlerësuara në kredite në përputhje me sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) (Evidencat 13 & 18).</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës si dhe intervistave me stafin akademik dhe studentët e programit, doli në pah se programi i studimit MSCMN e ka prioritet aftësimin profesional në praktikën profesionale të studentëve, gjithmonë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e programit (Evidenca 39).</p>



	<p>Për më tepër, departamenti përgjegjës siguron jo vetëm personel mbikqyrës por edhe një gamë të gjerë institucionesh për kryerjen e praktikave profesionale të cilat zhvillohen në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve në MSCMN (Evidencat 18, Tabela 5 & 19).</p> <p>Në thelb, praktika profesionale ka si qëllim zbatimin e njohurive teorike në praktikë profesionale, shkathtësimin e studentëve në mjedisin real të punës dhe parapërgatitjen e tyre për integrimin profesional në tregun e punës (Evidenca 39).</p>								
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave” duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UMSH (Evidenca 1, Neni 75) Programet e studimit, përfshirë këtu dhe MSCMN, ofrohen në gjuhën shqipe pasi orientimi dhe audienca janë kryesisht lokale dhe kombëtare. Gjithsesi, Statuti i UMSH parashikon ofrimin e lëndëve në një nga gjuhët e BE në vartësi të programeve apo projekteve të përbashkëta të implementuara me IAL ndërkombëtare. Nga intervistat me stafin akademik, doli në pah se një pjesë e literatures së disponueshme në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë ofrohen në gjuhën angleze. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e pedagogëve (me studime PhD në vende të BE) demonstrojnë aftësi për të zhvilluar mësimin kryesisht në gjuhën angleze.</p> <p>Pavarësisht përpjekjeve intensive për rritjen e mobilitetit të studentëve, të paashikuara këto në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit (Evidenca 8) dhe në Marrëveshjet e Bashkëpunimit (Evidenca 19), në UMSH nuk ka student të huaj.</p>								
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Në Statutin e UMSH (Evidenca 1, Neni 87) dhe Rregulloren e Organizimit të UMSH (Evidenca 2, Neni 29) përcaktohen në mënyrë specifike procedura e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit edhe në gjuhën angleze.</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare operon tre Programe “Master Shkencor” të menaxhuara nga tre</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 14

<p>akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Departamente: i të Drejtës Civile, i të Drejtës Publike dhe i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.</p> <p>Programi Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” i koordinuar nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare është perceptuar, hartuar dhe implementuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi (L.80/2015) si dhe VKM Nr, 41, date 24.01.2018 (amenduar në vijim)⁸ në raport me tipin e komponentit mësimor, kategorizimin e lëndëve dhe perqindjet e kurseve.</p> <p>Bazuar ne evidencat e disponueshme (Evidencat 3, 4, 5 & 7) si dhe intervistat me stafin akademik, rezulton se UMSH ka përvojë të konsoliduar disavjeçare në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare e cila reflektohet si në cilësinë e organizimit të kapaciteteve ashtu edhe burimeve akademike të nevojshme për ofrimin e këtij Programi. Referuar burimeve njerëzore, stafi akademik i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare përgjegjës për Masteri i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, në vitin akademik 2020-2021 rezulton me 16 pedagogë nga të cilët 12 janë personel akademik efektiv dhe 4 me kontratë (Evidenca 18, Tabelat 1 & 2). Ndërkaq, Programit MSCMN ka në përbërjen e tij 12 pedagogë, nga të cilët 4 janë me titullin Profesor dhe figura të njohura në botën akademike të RSH, 1 me titullin Profesor i Asociuar, dhe 7 me titullin Doktorë (PhD dhe Dr).</p> <p>Për rrjedhojë, UMSH demonstroi se disponon përvojën, kapacitete dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e një programi studimi në nivel të dytë në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësisia kryesore përgjegjëse për Programin e studimit është Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, i përbërë nga departamentet e të Drejtës Civile, të Drejtës Publike dhe të Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Organizimi dhe struktura e këtij Fakulteti ka si synim ofrimin e njohurive bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme dhe ato specifike në fushën e shkencave juridike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” rezulton se është në përputhje të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të UMSH, si dhe të Departamentit përgjegjës për këtë program. Programi është gjithashtu në kohezion të plotë me nivelin e kualifikimit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p>Në nivel kombëtar, kodifikimin i programit është bazuar në nenin 86 dhe nenin 125, të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (80/2015).⁹ Referuar RVB-së, në nivel ndërkombëtar, kriteri i</p>

⁸ <https://www.fhf.edu.al/wp-content/uploads/2019/09/PVKM-41-ndryshime.pdf>

⁹ https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/AKTET_NENLIGJORE.pdf

	kodifikimit të Programit nuk është i aplikueshëm pasi mungon udhëzimi për përcaktimin dhe përkatësinë e modalitetëve të kodit të programit sipas sistemeve europiane të kodifikimit.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	<p>Njësia bazë përgjegjëse për Programin e studimit është Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MSCMN është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të Departamentin përgjegjës, i cili bashkëpunon me njësi të tjera si brenda fakultetit ashtu edhe në rang institucional/UMSH.</p> <p>Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor synon në përgatitjen specialistëve në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë, me aftësi dhe njohuri konkurruese sipas kërkesave të tregut të punës brenda dhe jashtë vendit (Evidenca 4).</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, ka karakter ndërdisiplinor pasi i ofron studentëve njohuri teorike dhe praktike të cilat kombinojnë dijet juridike në marrëdhëniet ndërkombëtare me ato ekonomike dhe historiko-politike. Në këtë kontekst, departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, dhe më konkretisht personeli akademik i Departamentit të Drejtës Publike, dhe ai i Financës Bankë dhe Kontabilitet i Fakultetit të Shkencave Ekonomike si njësi bashkëpunuese e sigurojë përputhje interdisiplinore si më lartë përmëndur.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe intervistave me stafin akademik, rezulton se UMSH siguron marrëdhënie funksionale bashkëpunimi brenda institucionit. Këto marrëdhënie rregullohen dhe sanksionohen përmes Statutit (Evidenca 1) dhe Rregullores të UMSH (Evidenca 2), të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (Evidenca 3, Kreu IX), të Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare (Evidenca 4) dhe të Programit “Master

<p>analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Shkencor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare (Evidenca 5), sipas parashikimeve të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015.</p> <p>Departamenti i Marrëdhënive Ndërkombëtare si njësi bazë përgjegjëse për MSCMN, në përmbushje të karakterit ndërdisiplinor, bashkërendon punën dhe ngarkesën mësimore me njësi të tjera brenda Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (me Departamentin e të Drejtës Publike), si dhe me Departamentin e Financë Bankë dhe Kontabilitet të Fakultetit të Shkencave Ekonomike.</p> <p>Analiza e vazhdueshme e punës reflektohet në Planin e Punës së FSHJMN për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021 (Evidenca 12), dhe Analizën vjetore të FSHJMN (Evidenca 22).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Referuar RVB, Strategjisë së ndërkombëtarizimit (Evidenca 8), Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me universitete dhe institucione të tjera (Evidenca 19), Listën e Institucioneve dhe Organizatave bashkëpunuese (Evidenca 18, Tabela 5), si dhe intervistave përkatëse vihet re UMSH, ka 11 bashkëpunime me Universitete të vendeve të rajonit,¹⁰ të cilat mund lehtësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare, zhvillimin e programeve të përbashkëta studimi, si dhe projekteve kërkimore.</p> <p>Nga intervista me stafin administrativ, doli në pah tendenca promovuese e bashkëpunimeve ndërkombëtare të UMSH me institucione homologe ndërkombëtare të materializura këto të fundit, në vizitat e programuar me Universitetin e Panocios, edhe me Universitetin e Tuscia në Itali. Axhenda e takime përmbledh aktivitete që lidhen me mobilitetin e stafit dhe të studentëve, organizimin e konferencave të përgashkëta shkencore, dhe ndërtimin e një diplome të dyfishtë, kryesisht për të mundësuar studentët me origjinë shqiptare të vijnë në UMSH.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Bazuar në evidencat e vënë në dispozicion, del në pah se në kontekstin e MSCMN, UMSH ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për praktikën e studentëve me një numër të konsiderueshëm institucionesh (Evidenca 18). Ky fakt reflektohet dhe në Planin Mësimor i cili parashikon zhvillimin e praktikës profesionale përpara punimit të diplomës (Evidenca 13).</p> <p>Lista e institucioneve që UMSH ka nënshkruar marrëveshjet përkatëse përfshin 72 institucione si OJF, Institucione shtetërore, biznese private, organizata informuese, institute studimi, dhe universitete (Evidenca 18, Tabela 5).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për</p>	<p>Si më sipër, UMSH ka vendosur marrëdhënie zyrtare bashkëpunimi me 72 institucione të cilat përfshijnë OJF, Institucione shtetërore, biznese private,</p>

¹⁰ <https://www.umsh.edu.al/c/51/bashkepunime>



<p>kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>organizata informuese, institute studimi, dhe universitete (Evidenca 18, Tabela 5).</p> <p>Këto marrëveshje kanë për qëllim realizimin e praktikave profesionale të studentëve të MSCMN, zhvillimi i të cilave kryhet sipas procedurave të përcaktuara në dokumentin Udhëzim për Praktikant (Evidenca 39).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar RVB, si dhe evidencave në dispozicion, UMSH prezantohet mjaft aktiv në nivel ndërkombëtar, tendencë kjo që reflektohet në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit (Evidenca 8). UMSH ka nënshkruar ose është në process nënshkrimi të një sërë marrëveshjeve me institucione homologe dhe qendra kërkimore të cilat janë me fokus kryesisht në mobilitetin e personelit dhe stafit, si dhe organizimin e konferencave të përgashkëta shkencore (Evidenca 19). Se fundi, UMSH është anëtar i Euro-Mediterranean University (EMUND)¹¹ dhe i Eurasian Universities Union (EURAS).¹²</p>			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Bazur në RVB, si dhe dokumentacionit në dispozicion, UMSH prezanton në mënyrë periodike listën e detajuar dhe dokumentuar të Aktiviteteve Shkencore në nivel institucioni (Evidenca 3). Direkt apo indirekt, këto reflektohen dhe në një sërë dokumentash të tjerë si Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit (Evidenca 6), dhe Strategjia e Ndërkombëtarizimit (Evidenca 8).</p> <p><i>Raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet përkatëse apo vlera e shtuar e tyre në raport me programin MSCMN janë të munguara.</i></p>			
<p>Skalla e përmbushjes së standardeve</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMSH, doli në pah politika praktike në mbështetje të publikimeve shkencore të personelit akademik. UMSH Press publikon kryesisht vepra shkencore të personelit akademik.¹³ Që nga viti 2010, UMSH boton Revistën Periodike Shkencore EUROMEDITERRANEAN.¹⁴ Në 16 numrat e kësaj reviste trajtohen tema aktuale në nivel kombëtar dhe rajonal si tranzicioni ekonomik dhe politik, sistemi bankar, migracioni, globalizimi, Ballkani Perëndimor, etj.</p>

¹¹ <https://www.umsh.edu.al/c/53/anetar-i-emuni>

¹² <https://www.umsh.edu.al/c/54/anetar-i-euras>

¹³ <https://www.umsh.edu.al/c/129/botime-umsh-press>

¹⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/69/revista-euro-mediterranean>

<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Sipas neneve 50 dhe 79 të Statutit, UMSH ka në përbërjen e njësisë kryesore qendra të kërkimit shkencor që kryejnë veprimtari kërkimore shkencore dhe zhvillimi (Evidenca 1). Më tej, në nenin 6 të Rregullores së UMSH (Evidenca 2) sigurohet financimi dhe përdorimi i strukturave në funksion të kërkimit shkencore. Në të njëjtin dokument, dhe më konkretisht në nenin 40, theksohet se një nga detyrimet e stafit akademik është të marrë pjesë në konferenca dhe të botojë në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ndërkaq, vlerësimi i ecurisë së rezultateve në fushën shkencore të stafit akademik është në kompetencat e Dekanit dhe Përgjegjësit të Departamentit (Evidenca 3 & Evidenca 18, Tabela 19).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>UMSH ka politika për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencore. Përveç gamës së gjerë të aktiviteteve shkencore,¹⁵ që përfshijnë trajnime, konferenca, webinars, promovime librash, UMSH ka vënë në dispozicion të stafit akademik UMSH Press dhe Revistën Periodike Shkencore EUROMEDITERRANEAN për të publikuar dhe promovuar rezultatet dhe arritjet shkencore të tyre.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Politikat që garantojnë mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe veprimtarisë kërkimore-botuese, janë të përmbledhura në një sërë evidencash midis të cilave janë Statuti (Evidenca 1, Neni 51), dhe Rregulloret përkatëse në nivel institucioni, fakulteti dhe departamenti (Evidencat 2,3,4).</p> <p>Bazuar në Nenin 51 të Statutit (Evidenca 1) dhe Nenin 8 të Rregullores së institucionit, UMSH ka ngritur Këshillin e Etikës I cili ka hartuar dhe miratuar Kodin e Etikës (Evidenca 2). Ky I fundit, trajton vlerat etike, akademike dhe institucionale në performancën e stafit akademik, administrative dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>UMSH inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor duke krijuar mekanizma incentivues në fushën e karrierës akademike. Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, në lidhje me MSCMN, del në pah se gjatë tre viteve të fundit ka një bashkëpunim konstruktiv midis pedagogëve dhe studentëve në aktivizimin e këtyre të fundit në aktivitete shkencore kryesisht në nivel departamenti (Evidenca 18, Tabela 22).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	


¹⁵ <https://www.umsh.edu.al/c/56/aktivitete-2019>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE


Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i Studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Cikli i këtij programi realizohet me ndjekje të plotë dhe kohëzgjatja është dy vite akademike, ku viti i parë akademik realizohet me përmbushjen e 60 Krediteve (ETCS) dhe viti i dytë me 60 Kredite (ETCS) Lëndët vlerësohen me Kredite (ECTS) sipas raportit 1/25 (1 ECTS kredit është i barasvlershëm me 25 orë pune mësimore dhe individuale të studentit)</p> <p>Programi është hartuar bazuar në legjislacionin në fuqi dhe VKM Nr 41 datë 24.01.2018, i ndryshuar. Sipas kësaj VKM-je, në një Master Shkencor, raporti LËNDË BAZË + LËNDË KARAKTERIZUESE nuk duhet të jetë më pak se 60% në lidhje me totalin e lëndëve. Programi përputhet me këtë raport.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Masteri në Marrëdhënie Ndërkombëtare, për nga vetë multidisiplinariteti që i karakterizon, e ofrojnë këtë shumëllojshmëri profesionale e specialitetesh. Tek Strategjia e Zhvillimit të Programit (Evidenca 7) gjithsesi citohet: “Pas përfundimit të këtij studimi...studenti aftësohet për mundësinë e studimit në sektorin publik dhe në atë privat...”</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimi Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare jep njohuri të përparura në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare e Diplomacisë, si edhe në fushën e organizatave ndërkombëtare, teorive të integritimit, organizimit, funksionimit dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian (Përmbledhje e programit, Evidenca 18).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare i përgjigjet nevojave të të diplomuarve për tu formuar sa më mirë në planin teorik të fushave kryesore të studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Lënda Teoria dhe praktika e Diplomacisë si edhe Praktika pranë MEPJ-së e përmbushin më së miri nevojën e aftësisimit për zgjidhjen e problemeve komplekse e të papritura në fushën e specializuar përkatëse (Programi i Masterit, Evidenca 13).</p>

<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Struktura e programit të studimit plotëson të gjithë elementët e një strukture në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe VKM Nr 41 datë 24.01.2018, i ndryshuar (VKM-ja dhe Përmbledhësja, Evidenca 18).</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në lëndë/module ku përcaktohet qartë veprimtaria formuese e tyre dhe në bazë të rëndësisë që ato kanë për programin në formimin profesional të studentëve, përcaktohet dhe numri i krediteve (ECTS).</p> <p>Veprimtaritë formuese të programit (sipas Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCM) janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Të formimit të përgjithshëm e atij karakterizues (gjithsej 80 ECTS), b) praktikë profesionale (12 ECTS) dhe c) teza e diplomës (18 ECTS). 			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Realizimi i mbrojtjes së diplomës konsiston në një punë kërkimore-shkencore të studentit, sipas një teme të përzgjedhur në lidhje me fushën që i përket, nën drejtimin e një pedagogu udhëheqës.</p> <p>Diploma është pjesë përbërëse e planit mësimor të programit të studimit dhe pasqyrohet si detyrime përmblyëse e kategorisë E. Ajo vlerësohet me 18 ECTS dhe realizohet gjatë semstrit të dytë të vitit të dytë (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti përgjegjës për organizimin e Programit të studimit Master i shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare është Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.</p> <p>Ky Departament përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Ai ka një përbërje 9 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët 4 janë me grada dhe tituj dhe 5 anëtarë me kontratë (Evidenca 13-Programi Master; Evidenca 18-Përmbledhje).</p>




<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike pasi ka në përbërjen e tij anëtarë të kualifikuar dhe specialistë të fushave të ndryshme të cilët kategorizohen në: profesorë, lektorë dhe asistent-lektorë, sipas përcaktimit në Statutin dhe Rregulloren e Organizimit të UMSH (Evidenca 18-Përmbledhje; Evidenca 5. Rregullore e programit të studimit MSC MN, neni III).</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Në përbërjen e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka pedagogë me përvojë të gjatë mësimore e akademike dhe personalitete të njohura të fushës diplomatike. Personeli akademik dhe drejtuesit kryejnë veprimtari si: mësimdhënia, kërkimi shkencor, shërbime në zhvillim të institucionit, këshillim për studentët, tutoriat e detyra administrative. Personeli akademik ndahet në personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Programi i studimit është hartuar në përputhje rregulloren për organizimin dhe punën e DMN, me një përbërje prej të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 janë me grada dhe tituj, konkretisht 9 PAE dhe 5 PAK (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN; Evidenca 5. Rregullore e programit të studimit MSC MN, neni III)</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>DMN është pjesë e FSHJMN. Ato bazohen tek Statuti, aktet e tjera të UMSH si dhe rregulloret e tij dhe të departamenteve. Të drejtat dhe përgjegjësitë e çdo njësie janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit. Kompetencat e pedagogëve janë të specifikuara në rregullore. Sekretaria mësimore është plotësisht funksionale në këtë drejtim. Evidenca 4. Rregullore e DMN, Neni 7, pika 3</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Nuk ka të dhëna që DMN angazhon Personel akademik ndihmës me qëllim realizimin e programit mësimor.</p> <p>Personeli ndihmës mësimor-akademik kryen veprimtari këshillimi për studentët dhe detyra administrative, në kuadrin e veprimtarisë së DMN.</p> <p>Programi nuk parashikon aplikimin e praktikave laboratorike e klinike.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale.</p> <p>Në DMN koordinatori i angazhuar me këtë detyrë ishte pedagogia Xh. Krasta e cila e zhvillonte me shumë përkushtim këtë detyrë prej disa vitesh. Kjo detyrë ishte e reflektuar edhe në kontratën e punës individuale të saj</p>




praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	(Evidenca 3 - Rregullore e FSHJMN, Neni 20 - Evidencë: Takimi me stafin akademik në UMSH).			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Koordinatori i programit master i zhvillon të gjithë detyrat e tij në lidhje me mbarëvajtjen e këtij programi, sipas Rregullores (Evidenca 4. Rregullore e DMN, neni 7).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	FSHJMN dhe DMN përgjegjës për programin e studimit disponojnë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ato disponojnë dokumentacionin e plotë të programit të studimit si: Plani mësimor, syllabuset, rregullorja, stafi PAK dhe PAE i angazhuar për realizimin e programit dhe strategjia e programit (Evidenca 18 - Përmbledhje e tabelave; Evidenca 13 - Programi Master; Evidenca 7 - Strategjia e Zhvillimit të Programit)
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare është organizuar në lëndë/module, në përputhje me fushën e studimit dhe mundësitë për realizimin e praktikave profesionale. Struktura dhe përbërja e programit të studimit është në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore në fuqi. Në planin mësimor të programit të studimit janë të shprehura qartë lëndët, modulet, praktikat dhe aktivitetet formuese të cilat janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (Evidenca 18 - Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN; Tabela 9 - Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E)
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare zgjat 2 vite akademike. Organizimi i këtij programi është në përputhje me standardet europiane, sipas të cilave lëndët ndahen në sistemin evropian të krediteve ECTS. Programi ka gjithsej 120 kredite. (Evidenca 18 - Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN; Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E); Tabela 10. Plani mësimor MSCMN).



<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Planin mësimor i programit ka një informacion të detajuar mbi veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit dhe mbi komponentët mësimorë të cilët ndahen në: orë në auditor, (leksione, seminare, ushtrime/laborator, praktikë profesionale, diploma/provimi i formimit) dhe orë për studim individual/ jashtë auditorit, si dhe mbi format e kontrollit të dijeve, që në këtë program përgjithësisht janë me provime. Këto i gjen të parashikuar në detaje në syllabus-et e cdo lënde (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN; Tabela 13 Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit).</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pranimi i studentëve të rinj për të ndjekur studimet në FSHJMN në programin e studimit Master i shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare bëhet duke u bazuar në legjislacionin në fuqi të përcaktuar nga MASR, në Statutin dhe Rregulloren e Organizimit të UMSH dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhet publik në faqen zyrtare të UMSH, në broshurën informuese dhe gjatë fushatës së marketingut. Programi është i organizuar në mënyrë që të lejojë transferim të studimeve nga/në programe të tjera, duke bërë ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS. Kriteret e pranimit si edhe ato të tranferimit, janë të shprehura qartë në Rregulloren e Masterit, neni III dhe neni 15 (Evidenca 5: Rregullorja e Programit).</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Ana formale e programeve të studimit është në rregull, në përputhje me formatet e miratuara. Syllabuset janë të detajuar me të gjithë elementët e nevojshëm. Syllabuset e lëndëve hartohen nga titullari i lëndës/modulit shqyrtohen në departament dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit (Evidenca 13: Programet e Masterit).</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Syllabusi paraqitet nga titullari i lëndës, i cili ka të paktën gradën “Doktor i Shkencave”. Analiza e syllabusit bëhet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Njësia për Sigurimin e Cilësisë. Kjo analizë merr parasysh të gjithë elementët e tij thelbësorë duke u ndalur në përputhjen e plotë të tij me planin mësimor, bazën ligjore në fuqi, aktet rregullatore të miratuara nga UMSH si dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Rishikimi i syllabusit bazohet tek: Rifreskimi i literaturës, përshtatja e temave të trajtuara mes formimit teorik të lëndëve dhe zbatimit praktik të tyre, përshtatja e metodave të vlerësimit dhe ndërtimi i procedurave të barazvlerësimit.</p>



	<i>Përsa i përket anës përmbajtësore, një pjesë shumë e madhe e tyre nuk përmban literaturë të viteve të fundit. Literatura arrin deri në vitet 2011-2013 maksimalisht, ndonjëherë edhe në vitet 2009-2010. Pavarësisht se titullarët e lëndëve janë të kushtëzuar prej literaturës që gjendet në gjuhën shqipe, literatura e viteve të fundit, pra 2019-2021 mund të përfshihet tek ajo e këshilluara (Evidenca 13-Programi Master; Syllabusët e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit Master i shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Cdo lëndë/ modul i përfshirë bashkë me ngarkesën e tyre materiale, është përcaktuar sipas programeve të ngjashme. Për këtë program ngarkesa është 3000 orë mësimore në total që përputhet me 120 kreditet e tij.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Master i shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare është fokusuar në aftësimin e studentëve sin ë teori, ashtu edhe në praktikë. Për kryerjen e praktikave mësimore në programin e studimeve Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ka marrëdhënie bashkëpunimi efektive me përfaqësues dhe organizata të ndryshme të sektorit publik (MEPJ) dhe privat në Shqipëri.
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Të gjitha lëndët/modulet pjesë e programit të studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën e orëve mësimore që ato kanë, vlerësimin në kredite, rezultatet e të nxënit si dhe komponentët e vlerësimit. Forma e vlerësimit të studentëve do të jetë e unifikuar për të gjitha lëndët, duke përfshirë vlerësimin e tyre sipas aktivizimit në procesin mësimor, projekteve/detyrave të kursit, Provimeve të ndërmjetme si dhe provimit përfundimtar që realizohet në fund të lëndës/modulit, e cila konsiston në fund të semestrit. (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN; Tabela 10. Plani mësimor MSCMN).

<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit të studimit të ciklit të dytë është hartuar në përputhje me kurrikulën e programit MSC dhe me programe MSC të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare homologe në drejtimin e emërtimit të lëndëve, ngarkesës së krediteve por edhe raportit teori-praktikë.</p> <p><i>Sic është thënë edhe më sipër, mungojnë disa lëndë thelbësore për këtë profil si: Teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare e Metodat e Kërkimit Shkencor të profilizuar në marrëdhënie Ndërkombëtare,</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>UMSH zhvillon aktivitete me institucione shtetërore, kompani private dhe zyrat e punës që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve. Ato janë një pikë kontakti për punësimin, praktikat profesionale dhe internshpet e studentëve. Institucioni synon të shtrijë urat e bashkëpunimit mes tij dhe komunitetit të biznesit, për të krijuar lehtësi për punësimin e studentëve pas diplomimit. UMSH bashkë me njësitë e tij përbërëse ndjek politika favorizuese të punësimit të studentëve më të mirë edhe brenda institucionit, si edhe kualifikimin e stafit të tij akademik/administrativ. Institucioni është në përpjekje të vazhdueshme për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për realizimin e mobilitetit nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>Mobiliteti i Studentëve realizohet nëpërmjet procesit të transferimit dhe nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione analoge vendase (Evidenca 7. Strategjia e zhvillimit të programit MSCMN; Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN Tabela 23 mbi punësimin e të diplomuarve në programin MSCMN).</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p><i>Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) nuk janë të përditësuar duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</i></p> <p>(Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021).</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit iu ofron studentëve përvetësimin e njohurive bazë, si dhe pajisjen me instrumentet themelore të nevojshme për të përditësuar aftësitë e tyre, gjithashtu thellimin e njohurive, përfshirë ato ekonomike, juridike dhe historike, të cilat lejojnë vlerësimin e instituteve të së drejtës, duke mbajtur parasysh evoluimin e tyre.</p> <p><i>Në program mungojnë lëndët me zgjedhje të cilat ndihmojnë studentin të zgjedhë ato lëndë që përshtaten më shumë me planet dhe objektivat e tij për të ardhmen.</i></p> <p>(Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021).</p>

<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi synon të përgatisë ekspertë në MND dhe Diplomaci, të aftë për të konkurruar denjësisht në tregun vendas, atë rajonal të punës dhe më gjerë por gjithashtu iu mundëson studentëve vazhdimin e mëtejshëm të studimeve doktorale. Programi iu jep studentëve njohuritë që mund të merren në një sistem master i shkencës, i ndihmon ata për studime të avancuara, si dhe asiston ambiciet e studentëve për angazhime profesionale drejt tregut të punës ose Doktoraturë.</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Studentët përgatiten me metodat me bashkëkohore dhe në fund të programit të studimit të përshtaten sa më mirë me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Në programin e Masterit të shkencave në Marrëdhënie ndërkombëtare është bërë një ndryshim në dy nga lëndët e saj. Lënda International Relations in English bëhet Teori Politike E Shtetit, si edhe lënda Insitucione Dhe Administrate e BE-së bëhet Politika Ekonomike Të Krahasuara.</p> <p>Këto ndryshime kanë pasur si qëllim tjetër përshtatjen e programit me nevojat e tregut të punës si edhe akomodimin më të mirë të studentëve në tregun e punës, <i>por nuk kanë reflektuar rekomandimet e vitit 2018.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Kurrikula e programit garanton ndarjen e veprimtarive formuese në lëndë të formimit të përgjithshëm, karakterizues, plotësues, ndërdisiplinor i mundëson studentit avancimin në ciklin e tretë të studimeve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli i angazhuar në Masterin në Marrëdhënie Ndërkombëtare përfshin pedagogë të kualifikuar me grada dhe tituj shkencore me experience në mësimdhënie në fushat përkatëse si dhe ekspertë njohës të mirë të fushës përfshi ose akademikë e diplomatë me përvojë të gjatë sin ë jetën akdamike ashu edhe në atë publike, si të nderuarit prof. Paskal Milo e Ksenofon Krisafi (Evidenca. 13. CV e stafit akademik të programit të studimit MSCMN). Ky program ka pedagogë me kohë të</p>


	<p>plotë, por edhe kohë të pjesshme, të cilët angazhohen në realizimin e programit të studimit Master i shkencave (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN; Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.</p> <p>Duke u nisur nga Evidenca nr. 18, rezultojnë se stafi PAE mbulon mbi 70% të ngarkesës në program, konkretisht kemi 705 orë të parashikuara për stafin PAE dhe 135 orë nga stafi PAE, pra 84% PAE dhe 16% PAK. Kjo për qindje e parashikuar e ngarkesës është në linjë me VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, pika 2/b/ii ku thuhet se stafi akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore.</p> <p>Pedagogët të cilët mbulojnë këtë program zotërojnë kualifikimin e duhur shkencor në lidhje me titujt e gradat shkencore të verifikuara e të depozituara pranë Zyrës së Burimeve Njërëzore. Aktualisht ky program ka 4 prof. Dr, 1 prof. Asoc dhe 7 Ph.D (PAE+PAK).</p> <p>Stafi akademik ka studiuar pranë Universiteteve më të mira europiane e amerikane ose ka kryer specializime të standarteve të larta pranë tyre të doktoruar në universitete brenda dhe jashtë vendit (Evidenca. 13. CV e stafit akademik të programit të studimit MSCMN).</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Fushat akademike-kërkimore, si ajo e përgjithshme dhe ajo specifike e anëtarëve të personelit akademik, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Stafi akademik ka patjetër një formim me drejtim Marrëdhënie Ndërkombëtare ose derivate të Shkencave Politike/Sociale (Evidenca. 13. CV e stafit akademik të programit të studimit MSCMN).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike</p>	<p>IAL-ja në fjalë ka ngarkuar pedagogët e programit Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare me koordinimin e Masterit si edhe me orientimin e studentëve për Praktikën e Temat e Diplomave. Cdo student drejtohet nga një udhëheqës shkencor i cili ka gradën minimalisht Doktor Shkencash (Evidenca 14. Udhëzim për përgatitje Diplome; Evidenca 39. Udhëzim për Praktikën).</p> <p>Pedagogët kanë një ngarkesë në normë, në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi. Ata u shprehën se i kryejnë me përkushtim këto detyra.</p> <p>Veprimtaritë e tjera specifike sipas natyrës së këtij programi kanë të bëjnë me seminare specifike, shfaqje dokumentarësh, simulime e role-play të</p>

sipas natyrës së programit të studimit.	ndryshme në auditor (Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021; Aneks 3. Lista e aktiviteteve shkencore).			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Institucioni siguron personelin e nevojshëm për realizimin e orëve laboratorike në të gjitha programet ku ato aplikohen. Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	UMSH ka kontakte dhe informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës nëpërmjet partnerëve publikë e privatë . Këto informacione fakulteti dhe departamenti i merr në takimet dhe aktivitetet e përbashkëta me partnerë nga tregu i punës: kompani dhe njësi të pushtetit qendror e lokal ku zhvillohen praktikat, lektorë të ftuar, anëtare të bordeve të punës etj. (Evidenca 15: Programi i trajnimeve 2020-2021; Evidenca 19. Marrëveshje bashkëpunimi).
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimin të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.	Institucioni vazhdimisht realizon diskutime të ndryshme mes studentëve dhe njërive kryesore përgjegjëse për programin për strukturën e programit, ndryshimet që mund të ketë, etj. Cdo propozim nga diskutimi reflektohet në bazë të interesit të përmirësimin të programit. Ai miratohet nga struktura bazë e pastaj përcillet në instancat më të larta që të vihet në zbatim.
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Institucioni shfrytëzon rrjetin Alumni për të qenë në kontakt me studentët e diplomuar dhe për të vënë ata në funksion të institucionit që i formoi si edhe për të marrë prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit (Evidenca 15: Programi i trajnimeve 2020-2021; Evidenca 19. Marrëveshje bashkëpunimi).

<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>UMSH organizon programe specifike në fushat e ekspertizës që mbulon ky program, si për shembull trajnime me fokus përmirësimin e mësimdhënies, të aftësimin të pedagogëve për metodat e e-learning etj (Evidenca. 15: Programi i trajnimeve për vitin 2020-2021).</p> <p>Gjithashtu, praktikat mësimore për studentët në këtë program studimi zhvillohen pranë insitucioneve e insituteve specifike që kanë lidhje me programin (Dokumentacioni shtesë: Lista e institucioneve për realizimin e praktikës profesionale) me qëllim përmirësimin e programit por edhe aftësimin e studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat e Programit (Evidenca 5. Rregullore e organizimit të programit) dhe disponon një plan të qartë të kërkimit shkencor që përputhen me strategjinë e zhvillimit të institucionit (Evidenca 7. Strategjia e zhvillimit të Programit).</p> <p><i>Në këtë Strategji, vendoset si objektiv zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulës dhe i cilësisë së mësimdhënies, elementë të cilët rezultojnë të papërditësuar nga vëzhgimi i syllabuseve dhe i zhvillimit akademik individual të stafit. Kjo e fundit, mund të jetë e ndikuar edhe nga pandemia e këtyre dy viteve të fundit, por gjithsesi mund të ishte bërë më shumë në drejtim të publikimeve në revista shkencore apo trajnimeve individuale të pedagogëve ose specializimeve të tyre, nëpërmjet formave online.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare nxit veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore e artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit, sic është e përcaktuar edhe në Satutin e këtij Universiteti (Evidenca 1. Statuti i UMSH-së: Neni 50)</p> <p>Pjesëmarrja e pedagogëve në Konferenca jashë vendit dhe në programe kërkimore shkencore e dëshmon më së miri këtë nxitje në respect të lirisë akademike dhe fushës së tyre të studimit. Kjo shprehet qartë edhe në objektivat e zhvillimit të UMSH-së (Evidenca 6. Plani strategjik i Zhvillimit të UMSH-së).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në</p>	<p>Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore nëpërmjet aktiviteteve të</p>



studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	ndryshme të zhvilluara në Fakultet, me iniciativë të pedagogëve të programit (Evidenca 3 - Lista e aktiviteteve shkencore të FJShMN-së).			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Programi është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe orientohet nga integrimi evropian i vendit dhe pozicioni i tij në nivel global si dhe në zhvillimin ekonomik të tij. Diploma që përfitohet në fund të programit dhe suplementi i diplomës lejojnë studentin të transferohet në një IAL jashtë vendit për studime të mëtejshme.			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare realizon aktivitete të ndryshme studimore, kërkimore dhe shkencore në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Për këto aktivitete, ajo mbështetet financiarisht nga IAL-ja (Evidenca 17 . Të dhëna financiare institucionale).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni mbështet dhe parashikon grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor në bazë të Statutit (Evidenca 1) dhe Strategjisë për zhvillimin e programit (Evidenca 7). <i>Në praktikë, këto grupe nuk janë aktivizuar pasi nuk ka asnjë evidencë ose produkt konkret të punës së tyre kërkimore shkencore. Pedagogët vetë duhet të bëjnë më shumë në këtë drejtim, duke bashkëpunuar më tepër me njëri tjetrin në lidhje me fushat përkatëse të kërkimit shkencor.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësia bazë angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave, <i>por ende numri i projekteve kërkimore shkencore të fituara ose vëna në jetë është i vogël. Ndonëse ky sektor ka qenë i ndikuar nga uljet e fondeve financiare prej pandemisë, duhet bërë më shumë në këtë drejtim. Botimet në revistat me faktor impakti janë minimale në këto 3-4 vitet e fundit, pavarësisht se ka disa botime të mira (libra e revista shkencore) në nivel kombëtar.</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ka krijuar struktura të posaçme për mbarëvajtjen dhe mbikqyrjen e vazhdueshme të rritjes së cilësisë së punës

organizon konferenca ose aktivite, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	shkencore. Tregues konkret janë organizimi i konferencave shkencore, Webinare, leksionet e hapura, si dhe vetë punimet e stafit akademik dhe i studentëve në nivelin Master. https://www.umsh.edu.al/d/136/konference-shkencore-kriza-e-coronavirusit-sfidat-dhe-efektet-ekonomiko-sociale-te-saj-ne-nivel-global-dhe-ne-shqiperi-fare-do-te-ndodhe https://www.umsh.edu.al/d/73/umsh-organizon-konferencen-politika-e-shba-ne-balkanin-perendimor			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Në Planin Strategjik të Institucionit, UMSH i është referuar zhvillimit dhe përdorimit të metodave inovative të mesimdhënies si dhe nivelin e synuar të mësimnxënies përgjatë ciklit të studimeve (Evidenca 6). Në reportin vjetor të monitorimit, NJSBCZHK vlerëson në mënyrë periodike efikasitetin e veprimtarisë mësimore (Evidenca 21). Institucioni ofron gjithashtu forma alternative të mësimdhënies që shkojnë përtej leksioneve konvencionale, si leksione të hapura apo webinars.</p> <p>UMSH ka përgatitur një platform e-learning për komunikimin pedagog student dhe përgjate pandemisë e shoqëruar nga një udhëzues specifik për përdorimin e platformave të mësimit online (Evidenca 34). Siç doli në pah dhe nga intervistat me stafin akademik, UMSH ka ndërmarre masa të menjehershme për garantimin e vijueshmërisë së mesimdhënies gjatë pandemisë Covid-19.</p> <p><i>UMSH nuk ka hartuar një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) është struktura përgjegjëse për zhvillimin e mekanizmave të monitorimit. E njëjta Njësi vlerëson në mënyrë periodike (për semester) aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Detajet e procedurave janë të përmbledhura në Rregulloren dhe Manualin e NJSBCZHK (Evidenca 11 & 33), dhe konkretizohen më tej në Planin e punës së Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor për vitin akademik 2020-2021 (Evidenca 12).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeveve.</p>	<p>Bazuar në evidencat përkatëse si dhe intervistat me studentët, del në pah se UMSH garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të mësimdhënies. Ky process realizohet kryesisht nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit periodik anonim të pedagogëve nga studentët (Evidenca 25) si dhe fokus grupet e kryera me studentët (Evidenca 26).</p> <p>Një kontribut të mëtjeshëm në lidhje me këtë kriter luan dhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës (Evidenca 10) e cila ka si mision këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik dhe mbështetjen e Këshillit Studentor në mbrojtje të interesave të vetë studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK), Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (FSHJMN), dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare (DMN) janë strukturat përgjegjëse që garantojnë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 33

	monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në formë periodike (Evidencat 11, 3, 4) . Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në nivel institucional nëpërmjet publikimit të Raportit vjetor për monitorimin dhe sigurinë e cilësisë (Evidenca 21) .			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Te gjitha format e vlerësimit të aplikuara nga NJSBCZHK i shërbejnë UMSH të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme dhe cilësore procesin e mësimdhënies. Nëpërmjet publikimit ndërinstitucional dhe raporteve vjetore (Evidenca 21) sigurohet gjithëpërfshirja e aktoreve akademik dhe administrative në përmirësimin e programit të studimit. Në këtë mënyrë, mekanizmat e vlerësimit mund të kontribuojnë në nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e qasjeve pedagogjike dhe cilësisë në mësimdhënie.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit Master Shkencor në “Marrëdhëniet Ndërkombëtare” kombinon forma të ndryshme mësimdhënieje dhe mësimnxënjeje midis të cilave mund të përmenden leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktika profesionale dhe sesionet e konsultimit (Evidenca 18) . Përveç formave konvencionale, UMSH organizon leksione të hapura, konferenca dhe webinars për tematika që lidhen me fushën e programit të studimit. ¹⁶
Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Referuar evidencave dhe intervistave me studentët, personeli akademik respekton dhe iu përgjigjet nevojave dhe aftësive ndryshe të studentëve. Në Rregulloren për studentët me aftësi ndryshe, UMSH ofron informacion rreth politikave, procedurave, dhe shërbimeve të cilat kanë si mision garantimin e aksesit të barabartë dhe mjedisit mbështetës maksimal për studentët me aftësi të kufizuara (Evidenca 20) .

¹⁶ <https://www.umsh.edu.al/d/199/leksion-i-hapur-shqiperia-dhe-politika-e-saj-e-jashtme-ne-kontekstin-evropian-dhe-mesdhetar>



<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Referuar RVB si edhe intervistave me stafin akademik dhe administrative, është konfirmuar se UMSH disponon një plan programi trajnimesh që ka si prioritet si përmirësimin e kompetencave didaktike dhe metodave të mësimdhënies në përputhje me objektivat e institucionit (Evidenca 15). Institucioni organizon, gjithashtu, seanca trajnimi kryesisht për stafin e ri akademik me qëllim që të njihen dhe familiarizohen me dokumentacionin dhe aktet rregullative të UMSH.¹⁷</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në sjellimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në MSCMN është mjaft kompetent si nga pikëpamja e artikullimit të teorive dhe koncepteve të fushës, ashtu dhe larmisë së metodave dhe praktikës së mësimdhënies.</p> <p>Në këtë program studimi janë angazhuar profesorë me staturë të njohur akademike dhe publike në fushën marrëdhënies ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare (Evidenca 18, Tabela 6).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Te gjitha format e vlerësimi të aplikuara nga NJSBCZHK i shërbejnë UMSH të përmirësojë në mënyrë periodike format e metodat e mësimdhënies. Raportet vjetore sigurojnë gjithëpërfshirjen e aktoreve - duke përfshirë këtu edhe studentët - në përmirësimin e programit të studimit (Evidenca 21). Ky proces realizohet kryesisht nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit periodik anonim të pedagogëve nga studentët (Evidenca 25) si dhe procedura e punës me fokus grupet e kryera me studentët (Evidenca 26). Këto mekanizma kontribuojnë në përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies, dhe në ngritjen e cilësisë në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Bazuar në intervistat me personelin akademik dhe studentët e Programit të studimit Master Shkencor në “Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, vihet re se interaktiviteti dhe diskutimi janë mjaft të promovuara duke e bërë procesin e mësimdhënies-mësimdhënies tërheqës. Kjo konfirmohet gjithashtu dhe nga fakti se në këtë program angazhohen profesorë me staturë, prezence publike, dhe eksperiencë shumëvjeçare jo vetëm në fushën akademike por edhe të politikbërjes.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Ofrimi i metodave të përziera të mësimdhënies që kanë në qendër interaktivitetin dhe që ofrohen nga një personel akademik shumë i përgatitur, inkurajon autonominë dhe kreativitetin e studentit. Të kombinuara këto me hapjen e studentëve drejt ideve të reja dhe debateve rreth temave aktuale rajonale të zhvilluara në projekte kërkimore, konferenca, leksione të hapura dhe webinars kontribuon në pavarësinë akademike të studentëve (Evidenca 18, Tabela 22).</p>

¹⁷ <https://www.umsh.edu.al/d/180/trajnohet-stafi-i-umsh>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Bazuar në Relacionin e Verifikimit të Godinës (Evidenca 27), dhe Mjedisëve të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, vihet re se procesi mësimor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe të mirëmbajtura, të cilat plotesojne kushtet higjieno-sanitare (Evidenca 18, Tabela 16).
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Ambientet, hapësirat dhe infrastruktura e UMSH ofron kushtet funksionale cilësore për zhvillimin e procesit mësimor. Sallat e leksioneve, biblioteka, si dhe facilitetet e tjera janë plotësisht të pajisura me logjistikën e përshtatshme mësimore (Evidenca 27). UMSH operon një platform e-learning për zhvillimin e procesit mësimor përgjatë pandemisë e shoqëruar nga një udhëzues specifik për përdorimin e platformave të mësimin online (Evidenca 34).
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Sipas evidencave përkatëse dhe vizitës në institucion, del në pah se personeli akademik dhe studentët kanë akses të mjaftueshëm në përdorimin e infrastrukturës IT (Evidenca 18, Tabela 16). UMSH ka vënë në funksion platformë digjitale e-learning për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor përgjatë pandemisë (Evidenca 34).
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	Institucioni ofron literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar në shqip (nëse është e disponueshme) dhe anglisht për çdo silabus të MSCMN. E gjithë literatura si më sipër gjendet në formë fizike dhe dixhitale në bibliotekën e UMSH. Sipas procedurës së ndjekur nga institucioni, me fillimin e çdo semestri Përgjegjësi i Departamenti të Marrëdhënieve Ndërkombëtare kërkon blerjen dhe vënien në dispozicion të titujve të ri të literaturës pranë bibliotekës së UMSH.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka e UMSH ofron një numër të mjaftueshëm botimesh. Nga vizita në bibliotekën e institucionit dhe biseda me stafin dhe studentet, doli në pah se kjo strukturë garanton aksesin e teksteve kryesore të propozuara nga lektorët në formë fizike dhe digjitale. Menyra e pasurimit të bibliotekës ndjek në procedurë standarte institucionale në sigurimin e literaturës për të cilën kanë shprehur interes profesorët e lëndëve. Mjedisi dhe hapësirat e bibliotekës janë komode për


	përdorim nga studentët duke plotësuar kështoj standartet e një biblioteke funksionale dhe moderne (Evidenca 18, Tabela 16).			
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	UMSH ka vënë në shërbim te personelit akademik dhe studentëve librari on-line te fushave të përafërta me programin e studimit MSCMN. Duke iu referuar GVJ-së si dhe evidencave të vëna në dispozicion, sistemi i bibliotekës online të UMSH dhe fondi i literaturës elektronike operon në platformën digjitale Questia, e cila është kontraktuar për një periudhë njëvjeçare (Evidenca 18, Tabela 17).			
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Duke iu referuar RVB dhe vizitës në mjediset e UMSH, u vu re se infrastruktura laboratorike informatike dhe digjitale për programin e studimit MSCMN është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për t'u shfrytëzuar në çdo kohë nga studentët.			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	UMSH përdor një sistem informacioni e-learning në të cilën aksesohen në mënyrë të pavarur, në çdo kohë, dhe nga distanca (remotely), studentët dhe stafi akademik. Si pasojë e situatës së mbylljes nga pandemia Covid-19, UMSH vuri në funksion mësimdhënien on-line nëpërmjet platformës G-SUITE Zoom (Evidenca 18, Tabela 17).			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Në UMSH studentët dhe personeli akademik përdorin sisteme specifike për të mundësuar komunikimin e brendshëm që ka për qëllim aksesimin e dokumentacionit dhe dosjeve elektronike si silabuset, leksionet, detyrat e kursit, rezultate e provimeve. Ky komunikim mundësohet nga përdorimi i platformës SMS (Sistemi i Menaxhimit të Studentit) në të cilin kanë akses të gjitha strukturat e UMSH. ¹⁸ Manuali i përdorimit të platformës SMS mundëson personelin akademik të përdori në mënyrë efikase platformën online (Evidenca 31).			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Në dokumentin e “Udhëzimit për përgatitjen e Diplomës” së programit “Master Shkencor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, përcaktohen qartë roli, grada dhe detyrimet e personelit akademik në orientimin dhe mbështetjen e studentëve në përzgjedhjen e temave të diplomave (Evidenca 14, pikat 2 & 3).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁸ http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në UMN operon një strukturë e posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe zhvillimin e kurrikulave (NJSBCZHK). Kjo strukturë ka mision vlerësimin dhe raportimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe koordinimin e njëjësive/strukturave të tjera të institucionit (Evidenca 1, neni 84. Funksionimi i NJSBCZHK përcaktohet në Rregulloren e UMSH (Evidenca, neni 28).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare është njësia kryesore për supervizimin e cilësisë së mësimdhënies në nivel të njësisë kryesore dhe asaj bazë. FSHJMN dhe Departamenti i Marrëdhënies Ndërkombëtare ka si mision jo vetëm mbikqyrjen e programit por edhe implementimin e tij konform standarteve të cilësisë. Konkretizimi i këtyre standarteve përcaktohet në Rregulloren e Organizimit të UMSH dhe Planin e Punës së FSHJMN për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor për vitin akademik 2020-2021 (Evidenca 2, neni 23; Evidenca 12).
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare ka prioritet mbështetjen dhe zhvillimin e mësimdhënies nëpërmjet metodave inovative që shkojnë përtej atyre tradicionale, formave të avancuara digjitale, si dhe shërbimeve IT. Ky prioritet pasqyrohet në Planin Strategjik të Zhvillimit të UMSH 2018-2023 (Evidenca 6).
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referuar intervistave me personelin akademik dhe evidencave përkatëse, u vu re se UMSH i kushton një vëmendje të veçantë kualifikimit të personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor të tij. Kjo vëmendje konsiston në përmirësimin dhe rritjen e nivelit cilësor të mësimdhënies duke patur si objektiv pasurimin këtij procesi me dije, njohuri dhe të dhëna empirike nga dinamika e botës reale. Për arritjen e këtij qëllimi UMSH fokusohet tek: ndërkombëtarizimi dhe stimulimi i stafit akademik të pjesmarrë në projekte shkencore ndërkombëtare, organizimi i konferencave, ¹⁹ leksione të hapura, organizimi i webinarëve, ²⁰ dhe së fundi, botimi i punimeve shkencore si në UMSH Press por edhe në revista ndërkombëtare me faktor impakti.

¹⁹ <https://www.umsh.edu.al/d/136/konference-shkencore-kriza-e-coronavirusit-sfidat-dhe-efektet-ekonomiko-sociale-te-saj-ne-nivel-global-dhe-ne-shqiperi-fare-do-te-ndodhe>

²⁰ <https://www.umsh.edu.al/d/73/umsh-organizon-konferencen-politika-e-shba-ne-ballkanin-perendimor>




<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Referuar Programit të Trajnimeve 2020-201 konfirmohet se UMSH disponon njësi të posaçme që kanë si objektiv trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik (Evidenca 15).</p> <p>Nga intervistat e kryera me personelin administrative por edhe atë akademik, doli në pah se objektivi kryesor i trajnimeve është njohja e personelit akademik, veçanërisht atyre të punësuar rishtazi, me kuadrin rregullator të UMSH në lidhje me organizimin e procesit mësimor dhe metodikat përkatëse. Një kujdes i veçantë i është dhënë dhe trajnimit mbi ndërkombëtarizimin dhe rrjetëzimin në kuadrin e kërkimit shkencor dhe menaxhimit të projekteve kërkimore.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Sipas rregulloreve përkatëse janë stafi akademik dhe ai mbështetës në programin MSCMN përgjegjës për zbatimin e programit të studimit, si edhe për monitorimin e cilësisë në ofrimin e programit nepermjet vlerësimit të studenteve dhe vlerësimit institucional (Evidencat 4 & 5).</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie që përfshijnë leksione të hapura, guest speakers, webinars, diskutime në grupe, prezantim dhe diskutim mbi projekte kërkimore, etj. Përgjegjësi i departamentit monitoron, vlerëson dhe raporton në mënyrë periodike (semestrale dhe vjetore) rezultatet në cilësinë e mësimdhënies pranë dekanit.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Për vetë karakterin e Programit të studimit MSCNMN por edhe profilin e profesorëve që angazhon si në mësimdhënie ashtu dhe në poste drejtuese në FSHJMN, UMSH është IAL aktiv në përfshirjen e personaliteteve si vendas ashtu edhe të huaj në procesin mësimor. Më konkretisht, leksionet e hapur me të ftuar personalitete të fushës brenda vendit dhe të huaj janë në favor të shkëmbimit të ideve dhe metodave të mësimdhënies (Evidenca 3).</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5


Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------



<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare i ka të përcaktuara në rregullore te programit menyren e testimit dhe vlerësimit te njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale te studentëve (Evidenca 5).</p> <p>Studentet njihen qe në krye të herës me keto kritere nëpërmjet udhëzuesit të studentëve, prezantimit dhe shpjegimit të silabuseve, sistemit të vlerësimit të dijeve dhe njohurive. Të gjitha këto kryhen si nga stafi administrativ, ashtu dhe nga përgjegjësi i departamentit dhe nga pedagogët e lëndëve te programit (Evidencat 38).</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në Sillabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021 (Evidenca 13) si dhe në Udhëzuesin për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit përsëritës (Evidenca 36) janë përcaktuar qartë detajet e këtij kriteri.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Në dokumentin “Udhëzim mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimit të dimrit 2019-2020 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve” (Evidenca 35) janë përcaktuar qartë format dhe mënyrat e ndryshme alternative të vlerësimit të njohurive. Nga i njëjti dokument del qartë në pah mundësia që i jep UMSH studentit të demonstrojë njohuritë dhe aftësishtë e fituara përgjatë leksioneve dhe procesit të mësimnxënies.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë përmbushje</p>	<p>Përm.bushet pjesërisht</p>	<p>Përm.bushet kryesisht</p>	<p>Përm.bushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Bazuar në aktet rregullative të UMSH por edhe intervistave me studentët e Programit MSCMN, testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale ndjek një process linear duke përfshirë tre komponentë të ndërlidhur në funksion të mësimnxënies sa më cilësore. Këto komponent dhe i gjithë procesi i vlerësimit që mbështetet tek këto, reflektohet qartë në vlerësimin përfundimtar (Evidenca 18, Tabela 15).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat</p>	<p>Platforma online e vënë në përdorim nga UMSH, sidomos gjatë pandemisë, është e shtrirë përtej mësimdhënies. Kjo platformë ka inkorporuar operimin e sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit për të rritur transparencën akademike (Evidenca 34).</p>



eliminonjë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Sipas proceverbaleve të provimeve dhe Udhëzuesit “ <i>Mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimit të dimrit 2019-2020 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve</i> ” (Evidenca 35), konfirmohet se testimi i njohurive zhvillohet nepermjet tezave te provimit, te cilat hartohen nga titullari i lëndës. Njëri nga dy anëtarët e komisionit të posaçëm të testimit përfundimtar (njëri prej tyre është titullari i lëndës) përzgjidhet nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare me detyrën e monitorimit dhe garantimit të zhvillimit korrekt te testimit.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Aktet rregullative bazë të UMSH is dhe Udhëzimi “ <i>Mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimit të dimrit 2019-2020 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve</i> ” përcaktojnë qartë procesin dhe për më tepër garantojnë se testimi i vlerësimit të njohurive dhe dijeve zhvillohet në mënyrë anonime dhe me sekretim. Gjithashtu UMSH ka siguruar infrastrukturën e posaçme për të siguruar mbarëvajtjen e këtij procesi dhe transparencën akademike.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Referuar akteve rregullative të institucionit si dhe Udhëzuesit për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit përsëritës (Evidenca 36), procesi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale si dhe performancës së studentëve ndiqet nga pedagogu i lëndës në mënyrë të vazhdueshme dhe konstruktive. Thënë këtë, pedagogu i lëndës është i përfshirë në një sërë fazash ndërveprimi me studentin përpara dhe pas dhënies së vlerësimit përfundimtar. Këtu përfshihen seancat këshilluese, komentet verbale dhe me shkrim në lidhje me performancën, si dhe sugjerime për përmirësim të notës.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në Rregulloren e FSHJM (Evidenca 3, neni 49) parashikohen në mënyrë specifike masat disiplinore në rast konstatimi të fenomeneve të plagjiaturës ose kopjimit në provime.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimi i bazuar mbi meritën garantohehtë nëpërmjet Aktet rregullative bazë të UMSH si dhe Udhëzimi “ <i>Mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimit të dimrit 2019-2020 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve</i> ”. Këto garantojnë se testimi i vlerësimit të njohurive dhe dijeve zhvillohet në mënyrë anonime dhe me sekretim. Vënia në funksion e SMS (Sistemit të Menaxhimit të Studentit) lehtëson hedhjen në kohë nga ana e pedagogut të procesverbalit (online) të pikëve të provimeve sipas komponentëve analitik të vlerësimit.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje	Referuar Rregullores së FSHJMN (Evidenca 3, neni 66), vlerësimi paraprak i provimit iu behet i aksesueshëm studentëve nëpërmjet sistemit SMS (Sistemit të Menaxhimit të Studentit) dhe email-eve individuale në kohë reale. Studentet kanë të drejtë të kërkojnë sqarim për çdo paqartësi.

me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Ata kanë gjithashtu të drejtën e ankimit nëse janë të pakënaqur nga vlerësimi i pedagogut të lëndës duke kërkuar rivlerësimin e provimit. Ky proces rregullohet nga udhëzuesi përkatës i provimit dhe konform akteve rregullative të UMSH për komisionet e rivlerësimit.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Pasi kërkesa për rivlerësim është ezauruar në nivel Përgjegjësi Departamenti, atëherë është Dekani që vendos për vlefshmërinë e ankimit dhe për ngritjen e një komisioni të posaçëm të rivlerësimit të provimit dhe pikëve përkatëse (Evidenca 3). Gjithsesi, nga vizita në UMSH dhe intervistat me studentët dhe stafin akademik u konstatua se ky proces është jo i zakonit, pasi në shumicën e rasteve zgjidhja vjen nga Departamenti i MN.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Njësia bazë, Departamenti i Marrëdhënieve Nërkomëtare, është përgjegjës për zhvillimin e Programi të studimit MSCMN, për përgatitjen planit mësimor, programin e lëndeve, dhe përditësimin e sillabuseve përpara fillimit të vitit akademik. Objektivi kryesor është zhvillimi i programit të studimit MSCMN me qëllim që të garantojë thellimin e njohurive dhe të zhvillojë kane aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve duke reflektuar sfidat e tregut të punës (Evidencat 4 & 7).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit “Master i Shkencave në “Marrëdhënie Nderkomëtare”, i ofron studentëve njohuri teorike dhe praktike interdisiplinore të cilat kombinojnë dijet juridike me ato të marrëdhënieve nderkomëtare. Gjithashtu, programi i jep rëndësi aftësive të veçanta në fushën e kërkimit shkencor të avancuar (Evidencat 13 & 18). Megjithëse gjuha zyrtare e programit është shqip, nga intervistat me studentët dhe pedagogët në UMSH doli në pah se në nivele komunikimi dhe literature përdoret edhe gjuha angleze.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe sillabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Struktura dhe përmbajtja e sillabuseve të lëndëve të MSCMN janë hartuar në përputhjet me ligjin (dhe aktet nënligjore) për arsimin e lartë në RSH. Ato përmbajnë përshkrimin dhe objektivat e lëndës; konceptet themelore; metodat e mësimdhënies; format e kontrollit dhe të vlerësimit të studenteve; përmbajtjen e temave kryesore së bashku me literaturën e detyruar dhe të rekomanduar. Më konkretisht,

	kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studentët testohen dhe më pas analizohen nëpërmjet rezultateteve të provimit me shkrim, një teme projekti i cili prezantohet me gojë, vlerësimi nga udheheqësi i praktikës profesionale, etj.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Siç është parashikuar në sillabus, dhe në Rregulloret respektive të Departamentit të MN dhe të Programit të studimit MSCMN, pas përfundimit të temave të lëndës, pedagogu i lëndës i dedikon orë mësimore të veçanta studentëve për t'i orientuar për testin përfundimtar si nga pikëpamja e formës ashtu dhe e përmbajtjes së testit të provimit.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Realizimi i leksioneve të hapura me të ftuar vendas ose të huaj, webinar-et, apo dhe organizimi i konferencave mbi tema aktuale dhe të rëndësishme është një nga aktivitetet më të promovuara në UMSH. ²¹ Në të ftohen të ekspertë të fushës, pedagogë, dhe studentë.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Në programin e studimit MSCMN, mësimdhënia dhe ngarkesa akademike shpërndahet midis personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm mbi bazën e profileve shkencore të pedagogëve të angazhuar. Kjo qasje garanton cilësinë e lartë të mësimdhënies pasi i pajis studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike të transmetuara nga pedagogë që janë profesionistë të njohur në fushën e tyre dhe që e njohin mjaft mirë tregun përkatës të punës. Në vijim, studentët i aplikojnë aftësitë e përfituara në auditore në praktikën që zhvillojnë në institucione publike ose jo publike.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Nga intervistat me personelin akademik dhe studentët e MSCMN, doli në pah se pedagogët mbështetin fort diskutimet tematike në grup. Vetë profili i Programit të studimit ofron një qasje të tillë pasi natyra e temave në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare ka lidhje me divergjencat/konvergjenat apo konflikte midis shteteve në sistemin ndërkombëtar të qeverisjes.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Në UMSH, personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për mbështetjen dhe zhvillimin e ideve dhe trajtimin e temave të avancuara kërkimore dhe shkencore ku përshihen studentët. Kjo qasje konfirmohet dhe nga niveli i aktivizimit të studentëve në aktivitete të Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në periudhën 2018-2021 (Evidenca 18, Tabela, 22).

²¹ <https://www.umsh.edu.al/c/62/leksionet-e-hapura>
<https://www.umsh.edu.al/d/207/loja-leksion-i-hapur-nga-eljan-tanini>
<https://www.umsh.edu.al/d/170/partneriteti-publik-privat-themeluesi-i-umsh-se-anastas-angjelleksionetehapurper-studentet>


Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Një nga aktivitetet që nxit dhe mbështet zhvillimin e ideve inovative nga studentët është organizimi i Panairit të Ideve nga UMSH. Në këtë aktivitet janë prezantuar kryesisht punime të studentëve nën udhëheqjen e pedagogëve të tyre. ²²			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	UMSH dhe pedagogët e programit MSCMN, janë aktivë në ndërkombëtarizimin e programit duke krijuar ura lidhëse me institucione homologe kryesisht në rajonin e Evropës Juglindore. (Evidenca 19, Aneks 2).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në Rregulloren e FSHJMN (Evidenca 3, Kreu IX) dhe në Programin MSCMN (Evidenca 5) përcaktohen detajet e procedurës së posaçme për mbrojtjen e diplomës. Në vijim, procesi i diplomimit bashkë me dokumentacionin përkatës publikohet në faqen zyrtare të UMSH. ²³
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat përgjegjëse dhe më konkretisht Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare së bashku me pedagogët udhëheqës, orientojnë dhe asistojnë studentet gjatë të gjithë procesit të diplomimit. Të gjitha detajet e procedurës së diplomimit janë të parashikuara në Rregulloren e programit MSCMN (Evidenca 5, Kreu VI, Neni 24) dhe në dokumentin që përmban udhëzimet për përgatitjen e diplomës (Evidenca 14).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Sipas RVB ky kriter nuk është i aplikueshëm. Pas shqyrtimit të dokumentave të vëna në dispozicion si dhe intervistave me personelin akademik dhe administrative, një kriter i tillë nuk rezultoi i aplikueshëm.

²² <https://www.umsh.edu.al/d/214/panairi-i-ideve-studentet-prezantojne-iniciativat>

²³ <https://www.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Në programin e studimit MSCMN, personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm orienton dhe mbështet studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave mbi bazën e profileve shkencore të pedagogëve të angazhuar dhe interesave tematike të studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në programin e studimit MSCMN, UMSH në bashkëpunim me personelin administrativ dhe akademik ofron know-how dhe bazën teknike infrastrukturore për të asistuar studentët në kryerjen e studimeve empirike dhe laboratorike në përputhje me interesat kërkimore të tyre.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare asiston studentet në përcaktimin e temës së diplomës, metodologjinë dhe metodat empirike të aplikuara, dhe sugjeron literaturën e aksesueshme në fushën përkatëse të studimit. Pedagogët mbikqyrës janë në kontakt të ngushtë me studentët për përzgjedhjen e metodave të sakta të kërkimit që aplikohen në punimin e diplomës. Në dokumentin që përmbledh udhëzimin për përgatitjen e diplomës (Evidenca 14) gjenden të përcaktuara qartë procedurat e udhëheqjes së diplomës.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në rregulloret institucionale si dhe Rregulloren e Programit të Studimit të MSCMN (Evidenca 5, Neni 24) në përfundim të diplomës, studentët vlerësohen me notë.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në vijim të mbrojtjes së diplomës para komisionit, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj. Suplementi është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimeve të Studentëve (QSHA). Në dokumentin që përcakton modelin e diplomës dhe modelin e suplementit të diplomës përmbledhen të gjitha detajet përkatëse (Evidenca 13).</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, UMSH i vë në dispozicion studentëve të MSCMN, një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar. Tërësia e detajeve institucionale dhe proceduriale përcaktohen në aktet rregulatore të programit të studimit MSCMN (Evidenca 5, Kreu VI, Neni 24), të FSHJMN (Evidenca 3, Kreu X, Neni 53-54) dhe të Sekretarisë Mësimore (Evidenca 9).</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>UMSH ruan kopjet e dokumentacionit të studentit në zbatim të parashikimeve ligjore të L. 9154/06.11.2003 "Për arkivat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar".</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR
REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**


Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Të drejtat e personelit akademik, të përgjegjës për organizimin e programit të studimit dhe personelit ndihmës mësimor-shkencor përcaktohen edhe në Nenin 10,11 të rregullores së Programit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare.</p> <p>Pas ndarjes së ngarkesave mësimore në nivel Fakulteti informacioni i përcillet zyrës së burimeve njerëzore e cila bën më pas dhe një vlerësim të angazhimit dhe performacës vjetore të secilit prej anëtarëve (Evidenca 5. Rregullore e Programit të Studimit MSCMN, Neni 10,11). Departamenti është njësi në të cilën mbahen të dhënat për organizimin e programit të studimit. Zyra e menaxhimit të burimeve njerëzore luan rol kyç në menaxhimin dhe vlerësimin e performancës së burimeve njerëzore, administrimin dhe mbajtjen e dosjeve të punës duke ndjekur përmbushjen e kushteve të kontratës dhe respektimin me rigozitet të ligjshmërisë në punë.</p> <p>UMSH ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Kjo gjë u verifikua edhe përgjatë vizitës në IAL, në zyrën e burimeve njerëzore.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit të personelit efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) janë të standardizuara. Ato nisin me evidentimin e nevojës për punonjës nga njësi bazë dhe strukturat e tjera të UMSH-së, si dhe ndjek të gjitha hallkat e brendshme, të cilat janë të pasqyruara në Statut dhe në rregulloren e organizimit të tij (Statuti, UMSH Kreu VII Neni 57-58; Rregullore e organizimit të UMSH Kreu V Neni 38 -39).</p> <p>Në bazë edhe të nevojave të institucionit, IAL-ja angazhon edhe personel me kohë të pjesshme.</p> <p>Procedurat bazohen në vendimmarrje transparente përgjatë procesit të rekrutimit duke përshtatur kërkesat e vendit të punës me aftësitë profesionale dhe personale të kandidatit (Evidenca 29. Përmbledhje e procedurës së rekrutimit të stafit; Evidenca 32. Kërkesë për staf akademik DMN).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Sipas rastit vendosen kritere specifike të cilat janë kritere preferenciale në lidhje me pozicionin që do të mbulohet si dhe përputhshmërin e tyre me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Kriteret e punësimit si dhe rekrutimi i burimeve njerëzore shpallen publikisht në faqen zyrtare të UMSH duke informuar vendin vakant për të cilën ka nevojë institucioni, pozicionimi respektiv në organigramën e institucionit si dhe kriteret e përzgjedhjes.</p>

	Shpallja publikohet në faqen zyrtare të institucionit, rrjetet sociale, në median e shkruar dhe atë vizive. Gjithashtu, Institucioni bën publike organigramën e tij në faqen zyrtare të UMSH. (Evidenca 29. Përmbledhje e procedurës së rekrutimit të stafit).			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Procedura e rekrutimit parashikohet në Statutin dhe në Rregullore e organizimit të UMSH. Zgjedhja e stafit të brendshëm kryhet në bazë të kriterëve të përgjithshme dhe specifike, Përzgjedhja bëhet nga një komision <i>ad hoc</i> i përbërë në shumicë nga njësia bazë. Vlerësimi i kandidatit mbështetet në kriteret të përgjithshme që pasqyrojnë nivelin e duhur të kualifikimit. Këto kriteret garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	UMSH ka vendosur në dispozicion të realizimit të veprimtarive të mësimdhënies: salla leksionesh, seminaresh dhe laboratore. Sallat janë të pajisura me sisteme kondicionimi, mjete të nevojshme audiovizive, shërbim interneti, mbulim me sinjal WiFi, tabela shpjeguese dhe burime energjie të shumta për të vënë në funksionim pajisjet. Ato plotësojnë të gjitha kërkesat e sigurisë sipas ligjit. Zyrat e drejtuesve të njësive, të pedagogëve, të stafit administrativ dhe ndihmës janë gjithashtu të pajisura dhe me kushte të përshtatshme pune, në përshtatje me numrin e përdoruesve (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë).
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit të tij. Një nga prioritetet e UMSH është vlerësimi i aftësive të personelit si dhe ngritja profesionale e stafit akademik dhe atij ndihmës. UMSH mbështet pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, publikimin e punës së tyre kërkimore dhe mbështetje financiare për rritjen dhe kualifikimin e tyre profesional (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN; Tabela 19 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e




	studimit; Tabela 20 Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit).			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimit-shkencor.	Institucioni organizon vazhdimisht trajnime dhe programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja me qëllim kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programet e studimit (Evidenca 15. Programi i trajnimeve 2020-2021). UMSH gjatë pandemisë kishte trajnuar personelin akademik me metodat e reja në procesin e mësimdhënies <i>online</i> me qëllim kualifikimin profesional të tij (Evidenca 34. Udhëzues mbi përdorimin e platformave të mësimi online). https://www.umsh.edu.al/d/180/trajnohet-stafi-i-umsh			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Institucioni siguron menaxhim efikas të burimeve njerëzore. Në përputhje me objektivat e programit të studimit, personeli akademik është i angazhuar direkt në organizimin e programit dhe realizimin e planit mësimit. Ndarja e ngarkesës mësimore për personelin akademik është bërë duke iu përshtatur specializimit, eksperiencës në mësimdhënie dhe gradave e titujve shkencorë të pedagogëve, Nuk u vërejtën raste mbingarkese apo nënngarkese në IAL (Tabela 1 Numri i personelit akademik për çdo njësi; Tabela 2 Përbërja e njësisë përgjegjëse për programin e studimit).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni ka shfrytëzuar hapësirën e vet infrastrukturore dhe fasilitetet logjistike për t'i ardhur në ndihmë punës dhe veprimtarisë kërkimore të pedagogëve dhe studentëve. Zyrat e stafit akademik dhe atij mbështetës janë të pajisura me PC/laptopë, internet, kondicionim qendror etj. Institucioni garanton mjedis pune të sigurtë konform rregullave dhe standardeve përkatëse (Evidenca 27. Relacioni i Verifikimit të Godinës; Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë).

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>UMSH ka krijuar mjedise mësimore që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p>Mbi 50% e hapësirës anësore të të gjitha sallave është me dritare dhe ajrosje të mirë. Laboratorët kanë poste të pajisura me teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike.</p> <p>Sallat e bibliotekës janë të pajisura me revista, libra, programe mësimore të paraqitura në mënyrë të dukshme dhe funksionale për studentët dhe personelin akademik (Evidenca 27. Relacion i Verifikimit të Godinës).</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Të gjitha ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë kushtet për mësimdhënie, laboratorët, sallat e leksionit dhe mjediset e tjera të mësimdhënies janë të paisura me infrastrukturë moderne dhe paisje teknologjike të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik objektivave formues të programit të studimit MSCMN. Njësitë ndihmëse, laboratorët e informatikës, biblioteka, laboratorit i gjuhëve të huaja, janë në dispozicion të programit të studimit. Në funksion të mësimin për këtë program studimi dhe të tjerë, janë dhe laboratorët e informatikës (Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka laborator informatike të pajisur me kompjutera të gjeneratave të fundit ku janë instaluar programe të ndryshme sipas kërkesave të lëndëve. Mirëmbajtja dhe përditësimi i pajisjeve kompjuterike dhe programeve të instaluar sigurohet nga Zyra IT.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Institucioni garanton dhe u mundëson me mjediset e veta studentëve kryerjen e veprimtarive formuese sipas kërkesave të programeve të lëndëve dhe praktikës profesionale, sipas specifikimit të degës përkatëse, si pjesë përbërëse e planit mësimor. Kjo edhe nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe me institucionet publike dhe private në vend.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka një bibliotekë mësimore që institucioni në dispozicion të studentëve të të gjithë programeve, pa pagese dhe lehtësisht të aksesueshme. Sallat e Bibliotekës dhe sallat e leximit kanë sistem ngrohjeje e ftohjeje, por duke qenë <i>ne katin e poshtëm pa dritare, ka ende mundësi që të përmirësohet ndricimi e sistemi i ajrimit</i> . Sallat e bibliotekave janë të pajisura me rafta dhe në to gjenden tekste mësimore, libra, programe, revista për studentët dhe personelin akademik, <i>por vihej re një mungesë përditësimi e tyre më botime të reja të dy viteve të fundit. Botimet e reja qenë të kufizuara në numër.</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në bibliotekë numëroheshin mbi 4000 tituj librash, të gjithë në funksion të programeve të studimit të organizuara sipas fakulteteve, por botimet e reja të tyre si dhe të revistave shkencore ishin shumë të kufizuara. Biblioteka Online e Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” Questia (www.questia.com) <i>nuk ishte funksionale</i> . UMSH ka krijuar edhe një fondit të literatures elektronike me burimet e veta elektronike, i cili funksionon për të gjithë studentët.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UMSH ka krijuar Fondin e literatures elektronike. Kjo është një bibliotekë online e dedikuar për UMSH, në të cilën janë hedhur në formë dixhitale deri tani rreth 17.000 tituj, nga fusha të programeve të studimit që institucioni ofron. Të gjithë personat që kanë akses në sistemin e informacionit të UMSH, përmes faqes zyrtare të tij, mund të përdorin bibliotekën online dhe të shfrytëzojnë literaturën që ajo ofron. Ky fond librash, bashkë me ato që ofron Questia (në rast se ajo do të ishte funksionale) janë në dispozicion të personelit dhe studenteve të UMSH pa pagese, në funksion të punës mësimore dhe shkencore sipas fushave të interesit. http://sms.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Sallat e leximit janë të pajisura me poste leximi e studimi dhe PC të cilat janë të pajisura me programe kompjuterike si dhe pajisje teknike në shërbim të studentëve.

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>UMSH, normalisht, nxit njësite kryesore dhe ato bazë të paraqesin kërkesat e tyre për pasurimin e bibliotekës në çdo vit akademik duke vënë në jetë një proces i cili përditëson fondin e bibliotekës që i shërben programeve të studimit. Duket se ky proces nuk ka funksionuar më së miri këto dy vitet e fundit, ndoshta për shkak të pandemisë Covid-19.</p> <p>Një pjesë e titujve të rinj të shtuar në fondin e bibliotekës ishin botime të personelit akademik të UMSH, si tekste mësimore dhe libra të tjerë, dhuratë nga pedagogët e lëndëve, ose botime të UMSH Press.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimash të njohura, të cilat janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Oraret e shërbimit të bibliotekës janë në përshtatje me oraret e funksionimit të mësimin në UMSH në përgjigje të nevojës së tyre dhe në funksion të mësimdhënies.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	



Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies, komunikimit dhe bashkërendimit të të gjithë aktivitetëve, UMSH ka në dispozicion një sistem informacioni, i cili është në përputhje me misionin e saj.</p> <p>Menaxhimi i Sistemit të Studentëve synon koordinimin e punës së stafit akademik me stafin administrativ dhe studentët.</p> <p>Ky sistem përbehet nga dy panele kryesore: 1-Paneli i dedikuar për stafin akademik dhe ndihmës, 2- Paneli i dedikuar për studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe</p>	<p>Sistemi SMS konsiston në marrjen dhe dhënien e informacionit të kërkuar duke ruajtur privatësinë e rezultateve të studentëve. Institucioni ka realizuar informatizimin e tij në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor e shkencor. Ky sistem është i aksesueshëm edhe jashtë institucionit si nga stafi akademik ashtu edhe nga studentët.</p>



partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi Menaxhimit Uni Mesdhetar.			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Sistemi është vënë në funksionim me kapacitet të plotë që nga muaji dhjetor 2017. Me anë të këtij sistemi, çdo student e pedagog pajiset me një llogari personale për të ndërvepruar me sistemin informatik, duke lehtësuar koordinimin e proceseve të mësimdhënies e mësimnxënies midis studentëve dhe stafit akademik e atij ndihmës.</p> <p>Nëpërmjet sistemit lehtësohet puna e të gjithë pjesëmarrësve në marrjen dhe dhënien e informacionit të kërkuar duke ruajtur privatësinë e rezultateve të studentëve.</p> <p>http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi Menaxhimit Uni Mesdhetar</p>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>Në funksion të përmirësimit të komunikimit të studentëve dhe pedagogëve, si dhe ndërmjet stafit akademik e atij ndihmës, gjatë vitit 2020 institucioni ndërtoi dhe aktivizoi edhe sisteme të tjera komunikimi, që u përdorën me sukses në procesin mësimor, në atë organizativ dhe në aktivitetin shkencor (Evidenca 34. Udhëzues mbi përdorimin e platformave të mësimi online).</p>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<p>Sistemi i Menaxhimit të Studenteve ofron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për autoritete drejtuese. Nga ky sistem mund të përftohen: Raporte individuale mbi prezencën e stafit në orarin e duhur, raporte individuale për kërkimin shkencor, raporte individuale për cilësinë në mësimdhënie, raporte mbi frekuentimin e studentëve dhe raporte për mbylljen e procesit të vlerësimit brenda afatit të përcaktuar në rregulloret e programit apo të njësisë kryesore/bazë të cilët garantojnë realizimin cilësor të këtij programi.</p> <p>Komunikimi i këtyre raporteve nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik të UMSH mundëson informim në kohë reale të titullarëve dhe drejtuesve të strukturave përgjegjëse.</p>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	<p>Institucioni publikon në faqen zyrtare informacione që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, në gjuhën shqipe.</p> <p><i>Nuk ka ende pjesë të këtij website-i në gjuhën angleze.</i></p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/3/trerh-nesh</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	





Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UMSH ndjek një politikë transparente të përdorimit të burimeve financiare duke analizuar periodikisht treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare, nëpërmjet rishikimit të planit financiar dhe rialokimit të fondeve sa herë lind nevoja.</p> <p>Bordi i Administrimit kërkon në bazë të statutit raporte për realizimin e buxheteve, analiza të treguesve ekonomiko-financiarë dhe raport performance duke e përvijuar në mënyrë eksplicite drejtimin e tyre në rritjen e cilësisë së programeve dhe studimeve, përmirësimin e stafit akademik (duke zhvilluar një sistem pagesash dhe rekrutimesh mbi baza cilësie), investimin në përmirësime infrastrukturore të rëndësishme që lidhen me kushtet e punës dhe mesimdhënien, si hapësirat dhe një mjedis të plotësuar në kushtet e temperaturës, higjeno-sanitare, të ruajtjes fizike, dritës, kushteve sa më të mira të mesimdhënies dhe qëndrimit, operimin me sisteme teknologjike moderne të zhvillimit të aktiviteteve mësimore dhe shkencore (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN, Tabela 18 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit; Evidenca 17. Të Dhëna Financiare Institucionale; Evidenca 15. Programi i trajnimeve 2020-2021)</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Procesi i hartimit të planit të financimit është gjithëpërfshirës, respekton rregullat dhe parimet bazë të kontabilitetit dhe administrimit tatimor sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Detajimi i shpenzimeve të planit financiar është analitik dhe ka në themel nevojat ekonomike të departamenteve si njësi bazë e menaxhimit të aktivitetit të Institucionit. Alokimi i burimeve financiare bëhet në përputhje me objektivat që ka secili departament për zhvillimin normal të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore të UMSH, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre.</p> <p>Administratori i UMSH mbi bazën e propozimeve të njëjësive kryesore dhe të njëjësive bazë, harton çdo vit, planin e financimit dhe propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit. Ky plan siguron në mënyrë të qëndrueshme financimin e shpenzimeve për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Hartimi i planit të financimit kalon në disa hapa dhe ndjek procedura dhe afate të mirëpërcaktuara. Kalon në njësitë përgjatë linjës hierarkike, duke mbërritur në Bordin e Administrimit. Gjatë zbatimit të këtyre</p>

	<p>procedurave, hallkat e ndryshme mbajnë parasysh realizimin e nevojave vjetore të vazhdimësisë dhe zhvillimit me synim arritjen e qëllimit strategjik afatgjatë të zhvillimit të institucionit, për të realizuar misionin e themelimit të tij.</p> <p><i>Nuk duket të ketë pasur mjaftueshëm shpenzime për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line.</i></p> <p>Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN Tabela 18 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Në funksion të transparencës dhe rritjes së cilësisë së veprimtarisë, në institucion, me mbylljen vjetore të Pasqyrave Financiare, ato i nënshtrohen kontrollit dhe vlerësimit nga auditues ligjor të pavarur, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Institucioni auditohet çdo vit nga një Kompani Auditimi e çertifikuar, ku miratohet pozicioni financiar dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve të krijuara. Raporti i auditit të jashtëm fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.</p> <p>Pasqyrat Financiare, raportet që lidhen me to, si dhe raportet e auditit sikundër përcaktuar nga legjislacioni në fuqi janë publike. Situata financiare e Institucionit plotëson të gjitha standardet e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e plotë të aktivitetit duke siguruar plotësimin e të gjitha kriterëve ligjorë të Standardeve të Cilësisë.</p> <p>Një pjesë e të ardhurave i destinohet financimit të studimeve të studentëve të shkëlqyer ose të kategorive speciale, nëpërmjet bursave të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>UMSH ndjek një politikë transparente të përdorimit të burimeve financiare duke analizuar periodikisht treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare. Politika financiare ka në themel rritjen e efektivitetit të përdorimit të aktiveve të Institucionit duke rritur eficientë e përdorimit të mjeteve monetare dhe intensitetin e përdorimit të aktiveve.</p> <p>Gjatë kontrollit të buxhetit, që realizohet në mënyrë operative nga Administratori, evidentohen dhe korrigjohen shmangiet e përkohshme që mund të ketë për zëra të veçantë. Cdo ndryshim i buxhetit bëhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e Organizimit të UMSH.</p> <p>Zyra e Financë Kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Ajo ndjek zbatimin e të gjithë procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave vjetore të UMSH sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit si dhe bazuar në nenin 31 të Rregullores së UMSH (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për</p>



	programin MSCMN. Tabela 18-Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Pasqyrat Financiare, raportet që lidhen me to si dhe raportet e auditit sikundër përcaktuar nga legjislacioni në fuqi janë publike. Situata financiare e Institucionit plotëson të gjitha standardet e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e plotë të aktivitetit duke siguruar të gjitha kriteret e kërkuara ligjore të Standardeve të Cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin e programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje të plotë me LAL 80/2015 dhe duke u mbështetur në aktet juridike dhe rregullative të institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi (Evidenca 23. RVB; Evidenca 3. Rregullore e FSHJMN; Evidenca 4. Rregullore e DMN; Evidenca 5. Rregullore e programit të studimit MSCMN).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Të gjithë aktet e brendshme të UMSH garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit MSCMN (Evidenca 23. RVB; Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu X, Neni 80; Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH, Kreu I, Neni 2; Kreu II, Neni 4, pika 4-5; Evidenca 3. Rregullore e FSHJMN, Kreu I, Neni 1; Kreu VII, Neni 30, 32).
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Pranimi, regjistrimi, transferimi brenda dhe jashtë institucionit dhe diplomimi i studentëve në këtë program studimi realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të UMSH për çdo vit akademik dhe behen publike në faqen zyrtare të UMSH. Në këtë process, informimi bëhet edhe nga Sekretaria Mësimore, Kordinatori i Masterit dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në UMSH (Evidenca 23. RVB, Vizita në IAL). https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme https://www.umsh.edu.al/c/47/formulare-aplikimi https://www.umsh.edu.al/c/46/udhezime https://www.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Bazuar në aktet ligjore dhe rregulloren e programit të studimit, përputhje të plotë me LAL 80/2015: Neni 76, Pika 1, Institucioni shpall kriteret specifike të pranimit për çdo vit akademik. Kriteret publikohen në faqen online të UMSH dhe në ambjentet e institucionit (Evidenca 3. Rregullore e FSHJMN, Kreu I, Neni 1; Kreu VII, Neni 32, pika 2). https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e	Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhet publike në faqen zyrtare të UMSH, në rrjetet sociale (Facebook, Instagram etj.), në broshurën informuese si dhe gjatë fushatës mediatike dhe asaj online. Një rol mjaft të rëndësishëm luan edhe ZKSK e cila ngre grupe <i>ad hoc</i> për

kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	t'u kujdesur për informimin në kohë të kandidatëve të interesuar për të qenë pjesë e UMSH-s, si edhe për çdo ndryshim të ndodhur në program apo kritere pranimi (Evidenca 23. RVB). https://www.umsh.edu.al/c/46/udhezime https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	IAL-ja, në bashkëpunim me strukturat kompetente organizative, organizon javën e parë të çdo viti akademik, prezantimin e programit, rregulloret, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve. Njëpërmjet sekretarisë mësimore, studentët informohen për orarin mësimor, frekuentimin, datat e provimeve. Informacioni i detajuar mbi oraret, programin, njoftimet për provime etj, jepet edhe njëpërmjet faqes online të UMSH, tek sporteli në hyrje të UMSH (Evidenca 23. RVB; Evidenca 3. Rregullore e FSHJMN, Kreu III, Neni 14-26; Evidenca 5. Rregullore e programit të studimit MSCMN, Kreu IV dhe Kreu i V). https://www.umsh.edu.al/c/41/orari-mesimor https://www.umsh.edu.al/c/73/njoftimi-per-provime-2020 https://www.umsh.edu.al/c/42/kalendari-akademik https://www.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	IAL-ja, njëpërmjet DMN përgjegjës për MSC MN dhe sekretarisë mësimore, informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme dhe/ose studimeve të pjesshme. Ky informim realizohet njëpërmjet politikave institucionale të publikimit të informacionit (faqes së web-it (www.umsh.edu.al) si dhe njëpërmjet Udhëzuesit për studentet (Evidenca 38. Udhëzuesi i Studentit). Sa me siper cituar bazohen edhe në rregulloret e programit të studimit dhe rregulloret e Departamentit dhe të FSHJMN (Evidenca 23. RVB). https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e	Në javën e parë të semestrit, studentët njihen me syllabuset e lëndëve, të shpjeguara nga pedagogët përkatës.



<p>aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Për gjithçka që lidhet me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, studentit i vihet në dispozicion adresa elektronike e pedagogëve me të cilët zhvillojnë leksionet dhe seminarët, krahas adresës së pedagogut-tutor. Duke pasur ‘transparencën’ si elementin kyç për të ndërtuar një marrëdhënie sa më korrekte me studentin dhe për të përmisuar në çdo kohë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, studentët informohen nga pedagogu i lëndës për rezultatet e vlerësimit të shoqeruara me arsyetimet dhe shpjegimet përkatëse. Sistemi SMS është një element thelbësor në transparencën e vlerësimit. Studentët kanë akses në sistemin SMS, përmes llogarisë individuale, njihen me rezultatet e tyre (Evidenca 23. RVB; Evidenca 23 – RVB; Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>DMN mbështetur në rregulloren e programit të studimit, harton dhe bën publike listën e fushave të ekspertizës dhe temave orientuese për diplomat, sipas specialitetit dhe fushës së kërkimit të stafit akademik me grada dhe tituj shkencorë duke orientuar qartë studentët gjatë procesit të përzgjedhjes së temës së diplomës (Evidenca 23. RVB; Evidenca 5. Rregullore e programit MSCMN, Kreu VI, Neni 24). Studentët paraqesin kërkesat e tyre në departament për temën e zgjedhur dhe preferencën për udhëheqës, departamenti i shqyrton ato dhe cakton udhëheqësit nisur nga specialiteti dhe kualifikimi, eksperiencia personale dhe ngarkesa mësimore. Ky është një proces dinamik i cili vazhdon me zhvillimin e seancave këshillimore ndërnjet pedagogëve udhëheqës dhe studentëve deri në përfundim të punimit dhe dorëzimit në Departament (Evidenca 23. RVB; Vizita në IAL: Evidenca 14. Udhëzim për përgatitje Diplome). https://www.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>UMSH nëpërmjet stukturave të tij në mënyrë periodike publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p> <p>Të gjitha informacionet bëhen publike në faqen zyrtare të UMSH, në rrjetet sociale, gjatë panairit të shkollave, në broshurën informuese si dhe gjatë fushatës mediatike dhe asaj online Studentët potencialë mund t’a marrin informacionin për programin e studimit edhe pranë ambjenteve të UMSH apo pranë Sekretarisë Mësimore (Evidenca 23. RVB; Vizita në IAL).</p> <p>https://www.umsh.edu.al/media/5eb1c1162e146.pdf</p> <p>https://www.umsh.edu.al/media/5eb1bdf2672f.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit gjendet i publikuar në faqen zyrtare të UMSH (www.umsh.edu.al) dhe ne llogarime individuale te Studenteve ne SMS.</p> <p>Me anë të këtij sistemi, i cili koordinon veprimtarinë e proceseve të mësimdhënies e mësimnxënies midis studenteve dhe stafit akademik, çdo student e pedagog pajiset me një llogari personale për të ndërvepruar me sistemin informatik. Nëpërmjet sistemit lehtësohet puna e të gjithë pjesëmarrësve në marrjen dhe dhënien e informacionit të kërkuar duke ruajtur privatësinë e rezultateve të studentëve. Institucioni ka realizuar informatizimin e tij në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor e shkencor, i gjithë ky sistem është i aksesueshëm edhe jashtë institucionit si nga stafi akademik ashtu edhe nga studentët. Zyra Master është një strukturë tjetër që informon mbi programin e studimit studentet (Evidenca 23. RVB; Vizita ne IAL).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>DMN përgjegjëse për MSCMN, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore dhe koordinatorin e masterit, dhe nëpërmjet takimeve të hapura nëpërmjet kanaleve të informimit elektronik si faqen e web-it, apo në rrjetet e tjera sociale si facebook, instagram etj., ka vënë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit MSC MN të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm mbi rregulloret/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>(Evidenca 23. RVB; Evidenca 3. Rregullore e FSHJMN, Kreu III, Neni 14-26; Evidenca 5. Rregullore e programit të studimit MSCMN, Kreu IV dhe Kreu i V; Evidenca 38. Udhezuesi i Studentit).</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/41/orari-mesimor https://www.umsh.edu.al/c/73/njoftimi-per-provimet-2020 https://www.umsh.edu.al/c/42/kalendari-akademik https://www.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UMSH zhvillon aktivitete me institucione shtetërore, kompani private dhe me zyrat e punës që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve. Për çdo mundësi punësimi apo intershipi, studentët janë informuar përmes faqes zyrtare të UMSH-s, rrjeteve sociale (Facebook, Instagram etj.).</p> <p>(Evidenca 23. RVB; Vizita ne IAL; Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN Tabela 23 Mbi punësimin e të diplomuarve në programin MSCMN).</p>



	https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	DMN përgjegjës për programin e studimit MSCMN, në bashkëpunim me njësitë e tjera ndihmese si sekretëria mësimore, biblioteka, zyra master, laboratorit IT, etj. nëpërmjet kanaleve të informimit vizual apo elektronik, ju ofron studentëve informacion të plotë dhe të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Të gjitha strukturat funksionojnë si hallka plotësuese të njëri-tjetrit për t'i ardhur në ndihmë studentit dhe për të çuar përpara sukseshëm procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies (Evidenca 23. RVB).			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Menaxhimi i Sistemit të Informacionit realizon koordinimin e punës së stafit akademik me stafin administrativ dhe studentët. Portali i pedagogut është një element funksional i sistemit të informacionit në ndihmë të studentëve. Informacionet që jep sistemi janë të shfrytëzueshme me nivele, gjë që garanton një përdorim strategjik të tyre. Në këtë sistem hidhen të gjitha dokumentacionet në shërbim të programit. Studentët mund të komunikojnë lehtësisht në çdo moment edhe në distancë (Evidenca 23. RVB; Vizita në IAL). http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Menaxhimi i Sistemit të Informacionit SMS administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve (Evidenca 23. RVB; Vizita në IAL).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	UMSH disponon një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në çdo program studimi. Institucioni mban të dhëna për studentët e diplomuar për çdo vit akademik në çdo program studimi. Kjo u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve).

<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Institucioni mban të dhëna vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në të gjithë programet e studimit, tërheqjet nga to, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar). I gjithë informacioni ruhet në formë të përpunueshme në programet bazë për analiza të hollësishme. UMSH i ruan të gjithë regjistrat në formë të shkruar dhe në version elektronik, në administrimin e Sekretarisë Mësimore. Institucioni mban të dhëna për ecurinë e studentëve, nga regjistrimi deri në diplomim, për çdo program studimi. Të dhënat mbahen dhe përditësohen elektronikisht, gjithashtu edhe në <i>hard-copy</i> në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore (Evidenca 9 - Rregullore e Sekretarisë Mësimore).</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve të programit të studimit MSCMN, ku përfshihen të dhënat personale, numri i matrikullimit, vlerësimet, nota mesatare në hyrje dhe dalje etj, gjenden dhe menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe pranë Sekretarisë Mësimore (Evidenca 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore). http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>UMSH harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, Tabela 23. Mbi punësimin e të Diplomuarve në Programin MSCMN).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Studentët në UMSH janë të organizuar zyrtarisht në Këshillin Studentor bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Statutit të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë”.</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/5/krkimi-shkencor</p> <p>Këshilli Studentor i UMSH është një organizim i pavarur i studentëve i cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Ky Këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH (Evidenca 37. Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor).</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/62/leksionet-e-hapura</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/122/aktivitete-studentore</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UMSH garanton përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale vendimmarrëse sipas statutit të UMSH-së, të cilët zgjidhen nga Këshilli Studentor. Përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik realizohet nëpërmjet: Procesit të vlerësimit të pedagogut dhe të lëndëve, mbledhjeve të hapura të Departamentit dhe Këshillit Studentor përmes përfaqësimit nga Senatorët e grupeve respective, shprehjes së mendimit të tyre për lëndët dhe pedagogun në Fokus Grupe si edhe nëpërmjet formularit të vlerësimit (Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti).</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>UMSH merr masa për të shpërndarë ngarkesën akademike të studentëve sipas programit në semestra, në vit akademik, duke e ndërtuar kurrikulën e programit me lëndë të cilat respektojnë linjën e njohurive të fituara nga student (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCMN Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E).</p> <p>Në përputhje me objektivat e çdo programi studimi, i gjithë personeli i institucionit angazhohet direkt dhe indirekt në organizimin dhe realizimin e planit mësimor, në hartimin dhe përmirësimin e syllabuseve, në këshillimin e studentëve dhe në mbështetjen e aktiviteteve të tyre. Njohja e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme bëhet duke respektuar aktet ligjore dhe rregulloret e brendshme (Evidenca 5. Rregullore e Programit të studimit MSCMN).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe</p>	<p>Studentët i percjellin mendimet dhe idetë e tyre për programin nëpërmjet: Procesit të vlerësimit të pedagogut dhe të lëndëve, mbledhjet e hapura të Departamentit dhe Këshillit Studentor përmes përfaqësimit nga Senatorët e grupeve respective. Studentët shprehin mendimin e tyre për lëndët dhe pedagogun në Fokus Grupe si edhe nëpërmjet formularit të vlerësimit</p>



reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	(Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti).			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	Në statutin e UMSH-së dhe në rregulloren e programit të studimit MSCMN, është e saksionuar dhënia e të drejtës së studentëve për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e provimit nga ana e njësisë bazë dhe njësisë kryesore të FSHJMN si dhe pedagogut përgjegjës (Evidenca 5. Rregullore e Programit të Studimit MSCMN). Pas çdo provimi brenda dy ditëve, studentët informohen për rezultatet dhe nëse ka pakënaqësi ata kanë të drejtë konsultimi dhe pastaj nëse nuk bien dakort bëhet ankimimi pranë DMN (Evidenca 36. Udhëzim për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit përsëritës).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Institucioni harton strategjinë afatëgjatë të kërkimit shkencor dhe një hap pas hapi realizimin e objektivave. Cdo pedagog dorëzon një raport të hollësishëm të punës shkencore të realizuar gjatë vitit akademik dhe një planifikim për vitin pasardhës, si pjesë e kontratës së punës të lidhur me institucionin. Niveli i kërkimit shkencor vlerësohet periodikisht si në aspektin sasior ashtu dhe në atë cilësor (Evidenca 23. Raport i Vetëvlerësimit).
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	UMSH është angazhuar për ndërkombëtarizimin e tij përmes: a) pjesëmarrjes në rrjetet universitare EMUNI dhe EURAS, me të cilat në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe angazhohet në unifikimin e lëndëve të veçanta të kurrikulës për programet e studimit që ofron; b) pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, sidomos ato që financohen nga BE, me kontribut në hartimin e kurrikulave të reja dhe përmirësimin e kurrikulave ekzistuese, në punën kërkimore për fusha zhvillimi me interes për vendin dhe në proceset demokratizuese. c) Marrëveshjeve dypalëshe me Universitete të huaja <i>Një sforco më e madhe mund të bëhet në drejtimin e mëtejshëm të ndërkombëtarizimit, duke pasur parasysh se kapacitetet ekzistojnë, si në burime njerëzore e administrative.</i> (Evidenca 19. Marrëveshjet e Bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera dhe Dokumentacioni shtesë pas vizitës në IAL).

	https://www.umsh.edu.al/c/56/aktivitete-2019 https://www.umsh.edu.al/c/60/projektet https://www.umsh.edu.al/c/113/nderkombetarizimi
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	<p>Institucioni përpiqet të nxisë prirjet kërkimore shkencore nëpërmjet kumtesave të mbajtura në konferenca ndërkombëtare si edhe organizimin e panairit të ideve dhe konferencave shkencore me pjesëmarrjen e studentëve, etj.</p> <p><i>Nuk ka shembuj publikimesh studimesh e punimesh shkencore të studentëve. Kjo duhet të nxitet në të ardhmen.</i></p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/115/arkiva-konferenca; https://www.umsh.edu.al/c/74/konferenca-shkencore https://www.umsh.edu.al/c/132/aktivitete-staf https://www.umsh.edu.al/d/57/umsh-organizon-per-te-tretin-vit-radhazi-panairin-e-ideve</p>
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	<p>Institucioni ndjek një politikë favorizuese për publikimin e punimeve shkencore të pedagogëve.</p> <p>Të gjithë pedagogët e institucionit janë motivuar për të botuar në revista shkencore jashtë vendit. Në sistemin e vlerësimit të punës shkencore, sipas llojit të botimit është bërë dhe vlerësimi me pike e në revista me factor impakti apo të certifikuara.</p> <p><i>Nuk ka shembuj publikimesh studimesh e punimesh shkencore të punimeve apo tezave të studentëve. Kjo duhet të nxitet në të ardhmen (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit MSCM Tabela 19. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit).</i></p>
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	<p>UMSH dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe Start up, kjo realizohet në auditor dhe jashtë tij, me takime individuale dhe në grup.</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/133/ëbinare https://www.umsh.edu.al/d/57/umsh-organizon-per-te-tretin-vit-radhazi-panairin-e-ideve</p>
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	<p>Permes orëve faktike gjatë semestrit të dytë të vitit akademik, DMN ofron seanca këshillimore të diplomës, ku çdo pedagog udhëheqës, në ditë dhe orare të caktuara realizon takimet me studentët në ngarkim. Procesi i përgatitjes së diplomës kërkon asistimin e udhëheqësit të temës, për ta orientuar, ndihmuar studentin me mënyrën e kryerjes së tyre si dhe me mbështetjen institucionale për sigurimin e informacioneve, realizimin e testeve, analizave apo edhe matje të ndryshme. Pedagogu udhëheqës mban regjistër të veçantë për mbarëvajtjen dhe ecurinë jave pas jave të punimit për studentët në ngarkim deri në përfundim të diplomës (dorëzimi i punimit në Departament). Bazuar në Udhëzimin e Punimit të Diplomës çdo student mund të dorëzojë diplomën pas</p>




	firmosjes nga Pedagogu Këshillues, firma e të cilit vërtetohet konfirmimin e tij (Evidenca 14. Udhëzim për përgatitje diplome).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UMSH bashkëpunon me institute kërkimore-shkencore dhe universitete të tjera për të përmirësuar kurrikulat, rritur aktivitet shkencor dhe mobilitetin e stafit akademik dhe studenteve të Programit MSC MN.</p> <p>Institucioni organizon vazhdimisht konferenca shkencore në bashkëpunim me institucione dhe universitete brenda vendit. Synimi kryesor në to është evidentimi i mendimit të përparuar shkencor, shkembimi i informacioneve të reja në fusha të caktuara, bashkëpunimet e ndryshme në fushën e botimit (Evidenca 19. Marrëveshjet e Bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera dhe Dokumentacioni shtesë pas vizitës në IAL).</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/56/aktivitete-2019 https://www.umsh.edu.al/c/60/projektet https://www.umsh.edu.al/c/113/nderkombetarizimi https://www.umsh.edu.al/c/74/konferenca-shkencore https://www.umsh.edu.al/c/115/arkiva-konferenca</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Kërkimi shkencor dhe veçanërisht ai në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare përbën një nga prioritetet kryesore të Departamentit Marrëdhënie Ndërkombëtare. Sipas institucionit, ngritja e nivelit shkencor të pedagogëve shihet e lidhur drejtpërdrejt me ngritjen e nivelit të mësimdhënies në programin e studimit, paraqitjen e punimeve të tyre shkencore, shfrytëzimin e këtyre arritjeve në formën e materialeve mësimore për përgatitjen e detyrave të kursit që rrisin cilësinë e burimeve materiale që përdoren si literaturë plotësuese në lëndë të ndryshme. Realizimi i seancave këshillimore për punimin e diplomës përsos akoma më tej dijet dhe aplikimin e metodave me inovative të kërkimit shkencor.</p> <p><i>Mungesa e lëndës teorike bazë mbi qasjet në Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe specifikimi në Marrëdhënie Ndërkombëtare të lëndës Metoda të Kërkimit shkencor, krijon boshllëk në formimin e përgjithshëm të studentëve në lidhje me përgatitjen e tyre për ciklin e tretë të studimeve.</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>UMSH ka ndërtuar strategji zhvillimi dhe ndërkombëtarizimi, të lidhura ngushtë me projektet ose oferta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>UMSH ka realizuar partneritete mbi projekte të përbashkëta, lektorë të huaj të ftuar për të pasuruar programet mesimore, teknikat e mësimdhënien, etj por, edhe për të zgjeruar rrjetin e bashkëpunëtorëve (Evidenca 8. Strategjia e Nderkombetarizimit te UMSH).</p> <p>https://www.umsh.edu.al/d/276/projekti-universiteti-ne-sherbim-te-shoqerise-ne-shqiperi-zhvillohet-aktiviteti-me-partneret</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/74/konferenca-shkencore</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/115/arkiva-konferenca</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>UMSH ka ndërtuar strategji zhvillimi dhe ndërkombëtarizimi, të lidhura ngushtë me projektet ose oferta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Njesi te vecanta te UMSH vazhdimisht punojnë në këtë drejtim. Në këtë kuadër. UMSH jo vetëm ka mirëpritur e mirëpret partneritete mbi projekte të përbashkëta, lektorë të huaj të ftuar për të pasuruar programet mesimore, teknikat e mësimdhënien, etj por, edhe për të zgjeruar rrjetin e bashkëpunëtorëve. <i>Ka ende vend për shtimin e numrit të projekteve të kësaj natyre</i> (Evidenca 8. Strategjia e Nderkombetarizimit te UMSH).</p> <p>https://www.umsh.edu.al/d/276/projekti-universiteti-ne-sherbim-te-shoqerise-ne-shqiperi-zhvillohet-aktiviteti-me-partneret</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>UMSH promovon mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve nëpërmjet CEEPUS dhe Erasmus Mobility.</p> <p>Institucioni nëpërmjet kërkimit shkencor synojnë bashkëpunime me universitetet e tjera, me qendrat e institute kërkimore-shkencore dhe mbi të gjitha me bizneset, për të përmirësuar kurrikulat i cili ka në bazë përafrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë dhe shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik me qëllim organizimin e aktiviteteve te perbashketa.</p> <p>Nder objektivat e bashkepunimeve është jo vetëm ndërkombëtarizimi i punës shkencore, por edhe pjesëmarrja në projekte të përbashketa me interes reciprok në njohjen të lëndëve apo programeve (Evidenca 23. Raporti i vetëvlerësimit).</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/74/konferenca-shkencore</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/115/arkiva-konferenca</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/60/projektet</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Institucioni e konsideron bashkëpunimin si prioritet dhe në kuadër të zbatimit të strategjisë për bashkëpunim, ka vendosur marrëdhënie institucionale me universitete brenda dhe jashtë Shqipërisë, të cilat bëjnë pjesë në historikun e ngjarjeve shkencore të institucionit tonë dhe dëshmojnë për një traditë të konsoliduar kërkimore dhe bashkëpunimi të gjithanshëm.</p>



	<p>Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet homologe është një ndër aspektet kryesore të punës të UMSH (Evidenca 23. Raporti i vetëvlerësimit).</p> <p>https://www.umsh.edu.al/d/269/programe-te-perbashketa-doktorature-me-universitetin-italian-nenshkruhet-marreveshja-e-bashkepunimit</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/5/krkimi-sbkencor</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhinin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>UMSH ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të brendshme. Ato janë: Koordinator i programit të studimit, Sekretaria Mesimore dhe Departamenti. Këtu përfshihen edhe kanalet e komunikimit si faqja zyrtare e UMSH, Sistemi i Menaxhimit të Studentit, njoftimet në ambientet e UMSH dhe broshurat informuese (Evidenca 23 – RVB; Vizita në Institucion).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UMSH disponon Sistemin e Menaxhimit të Studentit (SMS) me anë të të cilit garantohet koordinimi i veprimtarive, informimi, këshillimi, ndjekja dhe përparimi i proceseve që kanë të bëjnë me programin e studimit.</p> <p>UMSH nëpërmjet strukturave të ngritura ofron asistencë për studentët lidhur me procesin mësimor, formimin akademik, zhvillimin e karrierës dhe çështje të tjera të jetës studentore. Nëpërmjet sistemit lehtësohet puna e të gjithë pjesëmarrësve në marrjen dhe dhënien e informacionit të kërkuar duke ruajtur privatësinë e rezultateve të studentëve (Evidenca 34. Udhëzues mbi përdorimin e platformave të mësimit online).</p> <p>https://www.umsh.edu.al/media/5ee210ca5f24f.pdf.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me</p>	<p>UMSH u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së posaçme, ku në mënyrë periodike jep informacion dhe orientim për kompletimin e ciklit të studimeve dhe sugjeron institucionet pranë të cilave do të zhvillohet praktika profesionale dhe potencialisht punësimi i tyre. Përveç punësimit, institucioni stimulon edhe vetëpunësimin duke organizuar seminare për gjetjen dhe zhvillimin e ideve të reja të biznesit dhe seminare për financimin e start-up-ve. UMSH zbaton politika favorizuese të punësimit të studentëve edhe brenda institucionit pas</p>

kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	mbarimit të ciklit të tyre respektiv të studimeve, veçanërisht pas ciklit të studimeve Master (Evidenca 23. Raporti i vetëvlerësimit; Vizita në IAL). https://www.umsh.edu.al/d/44/memorandumi-studentet-e-umsh-trajtime-dhe-keshillim-karriere-nga-the-headhunter			
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	ALUMNI është parë si një nga asetet më të vlera në vlerësimin e punës dhe arritjen e objektivave të UMSH. Vlerësimi i arritjeve të tyre në tregun e punës ose në vazhdimin e studimeve të tyre, është vlerësuar si dëshmia e arritjeve të punës cilësore të UMSH. Gjurmimi dhe mbajtja e kontakteve me studentët është një proces i cili funksionon teknikisht në koordinim ndërmjet DMNK, Zyrës së Programeve Master dhe gjithë strukturave në UMSH që ju ngarkohen detyra konkrete. ALUMNI është një rrjet i angazhuar, mbështetës dhe thelbësor për suksesin e Institucionit. UMSH dhe ALUMNI zhvillojnë aktivitete dhe leksione të hapura që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve sipas disiplinave të studimit (Evidenca 23. Raporti i vetëvlerësimit). https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private https://www.umsh.edu.al/d/127/alumni https://www.umsh.edu.al/c/133/webinare			
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	---	-----------------------	----------------------	-----------------------------------



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sipas parashikimeve të Nenit 103 të L. Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë” si dhe aktet nënligjore në vijim, UMSH ka hartuar politikën, strukturën dhe procedurën përkatëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Implementimi i tyre kryhet në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të IAL. Më konkretisht, Neni 84, Kreu XI i Statutit të UMSH parashikon politikat dhe strukturat lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe strukturat/njësitë përgjegjëse për hartimin dhe implementimin e tyre siç është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (Evidenca 1).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në zbatim të Nenit 84, Kreu XI të Statutit, në UMSH është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (Evidenca 1). Sipas Rregullores së NJSBCZHK misioni i kësaj Njësie është të vlerësimi periodik i veprimtarisë mësimore, i veprimtarive administrative dhe i kërkimit shkencor me qëllim që t’i përgjigjet standarteve shtetërore dhe udhëzimeve të Sigurimit të Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (Evidenca 11, Neni 1). Në përbërjen e kësaj Njësie përfshihen një drejtues dhe 7 anëtare me mandate 3 vjeçar (Evidenca 11, Neni 3). Në Nenin 9 të Rregullores theksohet se “<i>në rast nevoje, ftohet një përfaqësues ekspert I propozuar nga ASKAL.</i>”</p> <p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton përfshirja ose angazhimi i një bashkëpunëtori ose eksperti të jashtëm për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Instrumenta që UMSH ka vënë në funksion të sigurimit të cilësisë së veprimtarisë mësimore, veprimtarive administrative dhe kërkimit shkencor janë të duhurat. Më konkretisht, instrumentat e aplikura që kanë si qëllim të garantojnë dhe përmirësojnë cilësinë e veprimtarisë së UMSH janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi (L. 80/2015, Nenet 103 & 104), Statutin e UMSH (Evidenca 1, Nenet 53 & 84), Rregulloren e UMSH (Evidenca 2, Neni 28), dhe Rekomandimet respektive të ASCAL.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek</p>	<p>Sipas Rregullores dhe Manualit të NJSBCZHK (Evidencat 11 & 33), UMSH aplikon një politikë të qartë dhe ka në funksion procedura</p>

procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	periodike që kanë si qëllimin garantimin e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë së Programit të studimit MSCMN. Më konkretisht, Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mesimore, administrative dhe kërkimit shkencor. Në vijim, kjo Njësi harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet në vijim i komunikohen të gjitha njësive të UMSH me synim marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së veprimtarive të tyre në të ardhmen. Në Nenin 9 të Manualit të NJSBCZHK përcaktohet qartë vizioni i Njesisë për të krijuar kulturën e domosdoshme të vetëvlerësimit të UMSH.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Sipas Statutit të UMSH përcaktohet ngritja dhe funksionimi i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (Evidenca 1, Neni 84). Sipas përcaktimeve të parashikuara nga Rregullorja e NJSBCZHK misioni i Njesisë është vlerësimi periodik i veprimtarisë mesimore, i veprimtarive administrative dhe i kërkimit shkencor (Evidenca 11, Neni 1). Sipas së njëjtës Rregullore, raportet periodike të vlerësimit të brendshëm, i komunikohen të gjitha njësive të UMSH dhe më specifikisht njësisë bazë me qëllim marrjen e masave për përmirësimin dhe rishikimin e Programit të studimit “Master Shkencor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare.”
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	NJSB është struktura/njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UMSH, e cila planifikon, organizon dhe kryen vlerësimin e brendshëm periodik në nivel programi dhe në nivel institucional (Evidenca 11). Procesi i vlerësimit është i ndare sipas kategorive përkatëse në Manualin e NJSBCZHK (Evidenca 33). Në UMSH strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë Senati, Rektori, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Grupet e Vlerësimit të Brendshëm e cilësisë pranë Fakulteteve të udhëhequr nga Dekani (Evidenca 33, Neni 1).
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Në Rregulloren dhe Manualin e NJSBCZHK janë përcaktuar qartë detajet e metodologjisë së vlerësimit, instrumentat matës dhe vlerësues të Programit të studimit Master Shkencor në “Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, të miratuar nga Rektori. Këtu përfshihen vlerësimi i pedagogut dhe i lëndës sipas formularëve përkatës si për shembull

	formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues (Evidenca 24). I gjithë ky proces vlerësimi hartohet sipas një plan pune të FSHJMN për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021 (Evidencat 11,12 & 33).			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së veprimtarive mësimore shoqërohen me raporte periodike të gjetjeve të cilat i komunikohen Rektorit, Senatit dhe anëtarëve të Bordit (Evidenca 33, Neni 10). Senati dhe Bordi i UMSH marrin vendimet përkatëse të cilat reflektohen në planin strategjik të institucionit (Evidenca 6).			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Përveç formularëve dhe gjetjeve përkatëse, raporti i vlerësimit përmbledh të dhënat dhe gjetjet nga raporti paraardhës si dhe rekomandimet që burojnë nga ai. Bazuar në rezultatet e vlerësimit, në raportin vjetor të departamentit hartohet një plan veprimi për masat që do të merren për përmirësimin e mangësive të identifikuara të cilat do të adresohen në vitin tjetër akademik.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X


Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Sipas dokumentacionit në dispozicionit dhe intervistave me stafin administrative, u vu re se Programi i studimit Master Shkencor në “Marrëdhëniet Ndërkombëtare” vlerësohet periodikisht nga NJBC në nivel departamenti. Në përfundim të vitit akademik, UMSH e përfshin raportin e departamentit në vetëvlerësimin institucional në kuadër të vetëvlerësimeve të brendshme vjetore si dhe të akreditimit.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Në Rregulloren dhe Manualin e NJSBCZHK por edhe të Programit të studimit MSCMN janë përcaktuar qartë detajet e metodologjisë së vlerësimit, instrumentat matës dhe vlerësues. Në to përfshihet formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues, takimet me studentët e MSCMN dhe këshillin studentor si dhe fokus grupet (Evidencat 24 & 26).

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Sipas RVB, UMSH përdor një gamë të gjerë metodash specifike të tërthorta dhe të drejtpërdrejta për kryerjen e vlerësimit të cilësisë së Programit të studimit MSCMN. Gjatë intervistave kryesisht me studentët e programit u evidentua përdorimi i metodës së fokus grupit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Në Manualin e NJSBCZHK përcaktohet qartë se Grupi i Brendshëm i Vlerësimit përdor instrumentash të tërthorta vlerësimi si intervista me stafin akademik, jo akademik dhe studentët (Evidenca 33). Më konkretisht, në Nenin 4 të Manualit si më lartë bëhet fjalë për Grupin e Vlerësimit të Brendshëm i cili grumbullon të dhëna sasiore dhe cilësore, harton, realizon dhe përpunon të dhëna të marra nga intervista me të gjithë aktorët e përfshirë në realizimin e Programit studimor “Master Shkencor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare” të ofruar nga UMSH.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UMSH në Rregulloret dhe Manualët përkatëse ka parashikuar aktorët e brendshëm që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë së Programit të studimit MSCMN. Më konkretisht, në këtë proces përfshihen njesitë bazë/departamentet, stafi akademik, dhe studentët. <i>Bazuar në evidencat në dispozicion, vihet re se bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm nuk përmendet në mënyrë eksplicite.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njesitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në Statutin e UMSH përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat për të gjithë aktorët dhe strukturat të angazhuara në sigurimin e cilësisë së brendshme të institucionit. Në Rregulloren dhe Manualin e NJSBCZHK specifikohen qartësisht detajet e përfshirjes dhe e rolit të aktorëve institucional në këtë proces.</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njesisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren dhe Manualin e NJSBCZHK, konfirmohet se UMSH garanton përfshirjen e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, të personelit akademik dhe administrativ si dhe të studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së Programit MSCMN.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në aktet statutoare dhe rregullatore të UMSH, del në pah se procesi i përfshirjes së aktorëve të brendshëm në procesin periodik të vlerësimit, kryhet mbi parimin e respektimit të integritetit akademik dhe pa dallime apo diskriminime të natyrave të ndryshme.</p> <p>(Evidenca 3 & 4)</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p><i>Statuti i UMSH dhe Manuali i NJSBCZHK nuk parashikon bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm në procesin e vlerësimit të sigurimit të brendshëm dhe cilësisë.</i> Ndërkaq, Neni 9 i Rregullores së NJSBCZHK parashikon përfshirjen e një eksperti të jashtëm të propozuar nga ASCAL në rast se paraqitet nevoja.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadrin e sigurimit të brendshëm të cilësisë për Programin MSCMN janë qartësisht të përcaktuara në aktet statutorë dhe rregullatore të UMSH. Për rrjedhojë, ato janë tërësisht të aksesueshme si në formë elektronike në faqen e UMSH ashtu dhe offline për të gjithë të interesuarit. ²⁴
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UMSH publikon rezultatet e vlerësimeve të Raporteve Vjetore të NJSBCZHK në faqen zyrtare të institucionit sipas standarteve dhe kuadrit ligjor mbi lirinë dhe etikën akademike si dhe ligjin për të dhënat personale. ²⁵
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së veprimtarive mësimore shoqërohen me raporte periodike të gjetjeve të cilat i komunikohen Rektorit, Senatit dhe anëtarëve të Bordit (Evidenca 33, Neni 10). Përveç formularëve dhe gjetjeve përkatëse, raporti i vlerësimit përmbledh të dhënat dhe gjetjet nga raporti paraardhës si dhe rekomandimet që bërë nga ai. Bazuar në rezultatet e vlerësimit, në raportin vjetor të departamentit hartohet një plan veprimi për masat që do të merren për përmirësimin e mangësive të identifikuar të cilat do të adresohen në vitin tjetër akademik.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sipas Manualit të NJSBCZHK procesi vlerësues i cilësisë synon gjithashtu të identifikojë nevojat për ndryshim institucional dhe të programeve të studimit si dhe të sugjeroj formën ose format e ndërhyrjes në favor të përmirësimin të cilësisë.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Sipas evidencave në dispozicion vihet re se UMSH ka organizuar veprimtari periodike dhe trajnime me personelin por dhe me studentet, me qëllim informimin, ndërgjegjësimin por edhe aktivizimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së Programit të studimit “Master Shkencor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare” (Evidenca 15).

²⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

²⁵ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Personeli i angazhuar në programin Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” përfshin pedagogë të kualifikuar me grada dhe tituj shkencore me eksperience në mësimdhënie në fushat përkatëse, si dhe ekspertë njohës të mirë të fushës përfshirë dhe akademikë e diplomatë me përvojë të gjatë si në jetën akademike ashtu edhe në atë publike.
2. IAL ka në fokus studentin duke e reflektuar këtë filozofi në të gjithë hallkat e rrugëtimit të tij në këtë Institucion, që nga regjistrimi, paisja me leksionet online, përfshirja në një portal të dedikuar, ndjekja në temën e diplomimit etj. Një pjesë e të ardhurave të IAL-së i destinohet financimit të studimeve të studentëve të shkëlqyer ose të kategorive speciale, nëpërmjet bursave të studimit.
3. UMSH tregon një kujdes të vecantë në trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në aktivitetet e tjera ku personeli angazhohet. Institucioni organizon trajnimin e pedagogëve sipas nevojave dhe nivelit të kualifikimit të secilit, në drejtime si: Metodika e mësimdhënies, inovacionet në sektorë të ndryshëm, njohja e kuadrit rregullator të institucionit brenda kornizës së arsimit të lartë.

Pika të dobta


1. Në Analizën e Tregut të Punës mungon konkretizimi i diptikut kërkesë-ofertë i projektuar në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.
2. Disa lëndë si Metodatat e Avancuar të Kërkimit Shkencor ofron dije teorike dhe praktike të përgjithshme, jo të specializuara në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Gjithashtu, dijet themelore teorike mbi marrëdhëniet ndërkombëtare (p.sh. Teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare) nuk janë të përfshira në kurrikulën e programit.
3. Nga ana përmbajtësore, një pjesë e madhe e syllabus-eve nuk përmban literaturë të viteve të fundit. Literatura e përfshirë arrin deri në vitet 2011-2013, maksimalisht. Pavarësisht se titullarët e lëndëve janë të kushtëzuar prej literaturës që gjendet në gjuhën shqipe, literatura e viteve të fundit, pra 2019-2021 mund të përfshihet tek ajo e këshilluara.
4. Biblioteka Online Questia (www.questia.com) e cila do të kishte ndihmuar në drejtimin e përditësimit të kurrikulave dhe kërkimit shkencor, nuk ishte funksionale.



5. Në program mungojnë lëndët me zgjedhje të cilat ndihmojnë studentin të zgjedhë ato lëndë që përshtaten më shumë me planet dhe objektivat e tij për të ardhmen.

Rekomandime

1. Duhet bërë një analizë më e kujdesshme në lidhje me interesin që ka për këtë degë në tregun e punës duke përshtatur më shumë këtë Master me nevojat specifike të studentëve për t'i përgatitur ata me sfidat e reja të epokës së digitalizimit, transformimit shoqëror dhe revolucionit teknologjik.
2. Rekomandohet shtimi i lëndëve si Metodatat e Avancuar të Kërkimit Shkencor me fokus Fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare si lëndë bazë për një Master Shkencor i cili presupozohet të përgatisë studentë për kalimin në nivelin e Doktoraturës.
3. Duhet të rishikohen syllabus-et e programit dhe disa prej tyre të përditësohen me literaturën më të fundit.
4. Rekomandohet abonimi në një bibliotekë online e cila të ndihmojë pedagogët e studentët në punën e tyre shkencore.
5. Rekomandohet shtimi i 2-3 lëndë me zgjedhje ku studentët të zgjedhin në bazë të preferencave të tyre.




Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "International Relations" of the Institution of Higher Education "Mediterranean University of Albania"

Strengths:

1. The academic staff of the Study Program Master of Science in "International Relations" consist of highly qualified senior lecturers and professors with experience in teaching in the related fields. The faculty includes specialized experts, academics and diplomats with a long standing contribution in both academia and public life.
2. UMSH has a strong focus on the students, reflecting this philosophy in each of students' steps in the University: starting from enrollment, online text-books, tutership, their involvement in a dedicated portal and the mentorship during the graduation. Part of the revenues of the UMSH goes to the excellent students and to some special social categories, as study grants.
3. The UMSH pays a special attention to its staff members in the direction of their training and specialization for the purpose of the quality improvement of teaching and other academic activities. The institution schedules the training of the academic faculty according to their needs and their individual qualifications such as: teaching methods, innovation of different sectors, knowledge on the regulatory frame of the UMSH.

Weaknesses


1. The Labor Market Analysis lacks the concretization of the demand-supply diptych tailored to the local, regional and national levels in the field of international relations.
2. Some courses such as "Advanced Research Methods" provide general theoretical and practical knowledge, which are not specialized in the field of international relations. Furthermore, basic theoretical knowledge on international relations (such as "International Relations Theories") is not included in the program's curriculum.
3. With regards to the content, a large part of the program courses' syllabi do not contain up-to-date literature published in the recent years. The most updated literature found in the respective syllabi is of time cohort 2011-2013. Despite the fact that the courses' professors are conditioned by the literature available in the Albanian language, however, the literature of the recent years (e.g. 2019-2021) can be included in the recommended one.
4. The online library Questia (www.questia.com) was not functioning. It would have been helpful in terms of offering access to the recently published literature which in turn could have been essential for both updating the syllabi and informing the scientific research.



5. In this Master Program the elective courses are not included. They would offer students the possibility to select those courses that could fit more to their individual objectives and plans for the future.

Recommendations

1. A more careful analysis should be made regarding the labour market's interest for this field of study. This would help to adapt this Master Program to the specific needs of students, with an aim to better prepare them for the new challenges of the era of digitalization, the social transformation, and the technological revolution.
2. The better specialization of the course "Advanced Research Methods" by particularly focusing on the field of International Relations. Furthermore, the introduction of the "Theories of International Relations" as a core course for a Master of Science's Program which is supposed to prepare students for the Doctoral Program.
3. The revision of the study program's syllabuses and updating them with the latest literature available.
4. Subscribing to an online library, which could assist the both students and academic staff in their scientific work.
5. Introduction of 2 to 3 elective courses for students to have the opportunity to select courses according to their preferences.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURJMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X